

**HADITHE TË ZGJEDHURA  
RRETH MUAJIT RAMAZAN**  
(57 hadithe të sakta me shpjegime dhe dobi)

punoi: **Zejd Haziri**

**Hadithe të zgjedhura rreth muajit Ramazan  
(57 hadithe të sakta me shpjegime dhe dobi)**

*Përshtati dhe shpjegoi*

Zejd Haziri

*Redaktoi*

Arian Koçi

*Dizajni*

Bashkim Mehani

*Botues*

“Urtësia”

*Tirazhi:*

250 copa

Botimi i parë

1444/2023

**Katalogimi në botim – (CIP)**

**Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”**

28

Haziri, Zejd

Hadithe të zgjedhura rreth muajit Ramazan : (57 hadithe të sakta për muajin Ramazan) / Zejd Haziri.  
- Gjilan : Botimet Urtësia, 2023. - 42 f. ; 20 cm.

ISBN 978-9951-9105-5-2

# HADITHE *të zgjedhura rreth muajit Ramazan*

57 hadithe të sakta  
me shpjegime dhe dobi

**ZEJD HAZIRI**





بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ  
*Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit,  
Mëshirëplotit*

## PARATHËNIE

**F**alënderimi dhe lavdërimi i takon vetëm Allahut. Atë e falënderojmë, prej Tij ndihmë dhe falje kërkujmë. Allahut i kërkujmë të na mbrojë nga të këqijat e vetes dhe veprave tona. Atë që e udhëzon Allahu, s'ka kush ta humb dhe kush humbet rrugën e drejtë, s'ka kush ta udhëzojë përveç Allahut. Dëshmoj dhe deklaroj se s'ka hyjni tjetër që meriton të adhurohet pos Allahut, i Cili është Një, e pa ortak, dhe dëshmoj se Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve selem, është robi dhe i dërguari i Tij. Bekimet dhe lutjet qofshin për Muhamedin, familjen e tij fisnike, shokët e tij të ndershëm, dhe për të gjithë ata që ndjekin udhën e tij me mirësi deri në Ditën e Gjykimit.

Lexues i nderuar, në duar ke një përzgjedhje hadithesh rreth muajit Ramazan, vlerës së agjërimit dhe disa dispozitave të tyre të përmbledhura nga një kërkues i dijes, të cilat pastaj i kam

shoqëruar nga disa dobi dhe mësimë në pika të shkurtra, që kuptimi i këtyre haditheve profetike të rëndësishme të jetë sa më i qartë për lexuesin. Kështu bëhet më e qartë edhe vlera e këtij muaji dhe lexuesi mëson disa dispozita bazë të tij, në mënyrë që ta përjetojë dhe plotësojë agjërimin e tij në formën më të mirë. Këto dobi i kam nxjerrë nga librat e dijetarëve të mirëfilltë të këtij umeti, komentatorëve të hadithit, Allahu i mëshiroftë, në mënyrë të shkurtër dhe të shpejtë, meqë jemi në prag të Ramazanit, me shpresën që në botimin tjetër ta plotësojmë më shumë me dobi fetare të rëndësishme për agjëruesit e këtij muaji.

Të kuptuarit e hadithit është shumë i rëndësishëm për muslimanin sepse i jep perceptim të qëlluar për ta praktikuar atë dhe konsiderohet gjysma e dijes siç tha Imam Buhariu, rahimehullah: “E kam dëgjuar Alij ibn Medinin duke thënë: “Mësimi i kuptimeve të hadithit është gjysma e dijes, kurse njohja e burrave (transmetuesve) është gjysma tjetër e dijes<sup>1</sup>. Kjo e ruan besimtarin nga devijimet, meqë fraksioni i havarixhëve devijuan që në fillim si pasojë e moskuptimit të drejtë të fesë

---

1 Tehdhibul kemal (1/165).

dhe Pejgamberi, alejhi salatu ves selam, për ta tha:  
“E lexojnë Kuranin, por nuk e kalon fytin e tyre”<sup>1</sup>,  
pra nuk e kuptojnë atë.

E lus Allahu e Madhëruar që kjo punë modeste  
të jetë e dobishme dhe ta pranojë si sadaka rrje-  
dhëse e të më bëjë dobi atë ditë kur nuk të bën  
dobi as malli e as evlati, por vetëm dalja para Tij  
me zemër të shëndoshë.

Amin!

*I varfri për mëshirën e Zotit të tij*  
*Zejd Haziri*  
*1444 hixhrij / 2023, Gjilan*

---

1 Transmeton Tirmidhiu (2188).





## HADITHET E PËRZGJEDHURA

**1** I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

*“Ju erdhi juve Ramazani, muaji i begatë<sup>1</sup>”.*

Agjërimi i Ramazanit është një nga shtyllat e Islamit dhe themeli në obligueshmërinë e tij është Kurani, Suneti dhe ixhmai. Allahu i Lartësuar thotë: **“O ju që besuat, agjërimi (saum) u është bërë obligim sikurse ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm<sup>2</sup>”.** Nga Abdullah ibën Umeri transmetohet se i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: “Islami ndërtohet mbi pesë shtylla: dëshmia se s’ka Zot të adhuruar me të drejtë pos Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Tij, falja e namazit, dhënia e zekatit, kryerja e haxhit dhe agjërimi i Ramazanit<sup>3</sup>”.

Agjërim do të thotë ndalja gjatë ditës nga ngrënia, pija, marrëdhëniet intime e të tjera që janë përmendur në sheriat<sup>4</sup>.

---

1 Transmeton Nesai (2105), saktësoi Albani.

2 El Bekare: 183, 184.

3 Transmetojnë Buhariu (8, 4515) dhe Muslimi (16).

4 Sherhul umdeh, faqe 145, Fajsal Alu Mubarek, rahimehullah.

## **Fikhu i hadithit<sup>1</sup>:**

- 1) Dhuntia e Allahut ndaj robërve të Tij me llojshmërinë e sezoneve të të mirave dhe të adhurimit, në të cilat me pak punë të mira fitojnë shpërblime të mëdha.
- 2) Lajmërimi për ardhjen e të mirave të shumta dhe ngritja lart e shenjtërisë së tij.
- 3) Fjala “ju erdhi” në hadith është një sinjalizim se erdhi koha e garës në të mira, meqë pran-gosen shejtanët dhe mundësia për garim është e madhe, ndaj një zë nga qielli thotë: “O ti kërkues i së mirës, mësyja!”
- 4) Ibën Rexhebi, rahimehullah, ka thënë se sipas dijetarëve ky hadith është themeli në urimet e njerëzve për njëri-tjetrin kur vjen ky muaj sepse besimtari përgëzon kur hapen dyert e xhenetit dhe mbyllen dyert e xhehenemit.

---

1 Fikhu i hadithit, pra kuptimet e tij, mësimet, dobite e përmbajtja e tij, siç përmendet fjala fikh në Kuran: **“Ç’është me këtë popull që nuk kupton gati asnjë send?”** En Nisa: 78.

**2**I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

*“Mos t’i paraprijë dikush nga ju Ramazanit me agjërim të një ose dy dite. Vetëm nëse është dikush që ka qenë duke mbajtur agjërimin e tij<sup>1</sup>, atëherë le ta agjërojë atë ditë<sup>2</sup>”.*

**Fikhu i hadithit:**

- 1) Lejohet të thuhet Ramazan pa fjalën muaj përpara<sup>3</sup>.
- 2) Ndalohet t’i paraprihet Ramazanit me agjërim të një ose dy dite për t’u dalluar farzet nga nafilet<sup>4</sup> dhe adhurimet nga zakonet.
- 3) Është e lejuar kjo nëse rastis me agjërimin e

---

1 Ndonjë borxh nga Ramazani i kaluar ose ndonjë zotim (Fet’hul bari, 5/610, i Ibni Haxherit) ose nëse e ka pasur zakon të agjërojë të hënën dhe të enjten dhe këto ditë rastisin një ose dy ditë para Ramazanit, edhe pse disa dijetarë kanë thënë se këto agjërimet duhet të ndalen më herët për shkak të hadithit “Kur vjen gjysma e shabanit, mos agjëroni”, transmetuan Ebu Davudi, Tirmidhiu, Ibën Maxheh dhe e saktësoi Ibni Hibani.

2 Transmetojnë Buhariu (1914) dhe Muslimi (1082).

3 Zubdetul eham, faqe 751, S. Hilali.

4 Hulasatul kalam ala umdetil ahkam, faqe.177, Abdullah el Bessam, rahimehullah.

atij që e ka zakon të agjërojë vazhdimisht, si të enjten dhe të hënën ose për shkak të kohës së ngushtë i ka mbetur ndonjë kompensim nga Ramazani i kaluar. Ibën Haxheri, rahimehullah, ka thënë se kuptimi i hadithit është që mos ta presim Ramazanin me agjërim përpara me nijetin e rezervës për Ramazan. Tirmidhiu ka thënë se dijetarët e kanë urreyer që njeriu të ngutet me agjërim para se të hyjë Ramazani për shkak të përmbajtjes së Ramazanit<sup>1</sup>.

- 4) Nga urtësitë e ndalimit të këtij agjërimi para Ramazanit është sepse hyrja e tij është e lidhur me shikimin e hënës. Kush i paraprin me një ose dy ditë, e ka hedhur poshtë këtë vendim sheriatik të rëndësishëm dhe ky është mendimi i dijetarëve të thuktë si Ibën Haxheri<sup>2</sup> dhe e miratoi Shevkani në “Nejlul evtar” (4/350).

---

1 Fet’hul bari (5/609).

2 Fet’hul bari (5/610).

**3** Nga Amar ibën Jasiri, radijAllahu anhu, transmetohet se ka thënë:

*“Kush e agjëron ditën në të cilën dyshohet<sup>1</sup>, veçse ka kundërshtuar Ebul Kasimin<sup>2</sup>, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem<sup>3</sup>”.*

**Fikhu i hadithit:**

- 1) Ndalohet agjërimi i ditës së dyshimtë të muajit Ramazani dhe kjo ditë pa dyshim është fillimi i tij, kur ka dyshim se a është prej tij apo jo, natën e tridhjetë nga Shabani në rast se nuk shihet hëna e re.
- 2) Imam Tirmidhiu pas këtij hadithi ka thënë: “Këtë mendim kanë shumica e dijetarëve nga shokët e Pejgamberit, alejhi salatu ves selam, dhe pas tyre nga tabiinët, si dhe Sufjan Thevriu, Malik ibën Enesi, Abdullah ibën Mubareku, Shafiu, Ahmedi e Is’haku. Të gjithë

---

1 Dita në të cilën nuk është parë hëna dhe nuk dihet se a ka hyrë muaji Ramazan.

2 Ebul Kasim ishte nofka e Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.

3 Transmetojnë Nesaiu (2188), Ibën Maxheh (1645), Ebu Davudi (2334), Tirmidhiu (686) e të tjerët, e saktësoi Albani.

urrenin që njeriu të agjëronte ditën e dyshimit dhe shumica e tyre ishin të mendimit se nëse dikush e agjëron atë ditë dhe është nga agjërimi i Ramazanit, ai duhet ta kompensojë atë në vend të tij.

- 3) Ebul Kasim është nofka e Pejgamberit. Kasimi ishte i biri i tij me Hatixhenë, i cili thuhet se vdiq para shpalljes, por thuhet edhe pas shpalljes.
- 4) Dita e dyshimit mund të jetë edhe dita e tridhjetë e Ramazanit, kur nuk shihet hëna natën e saj për shkak të mjegullës<sup>1</sup>.

---

1 Subulus selam, 2/860.

**4**I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

*“Islami është ngritur mbi pesë shtylla: dëshmia se s’ka të adhuruar me të drejtë pos Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut, falja e namazit, dhënia e zekatit, kryerja e haxhit dhe agjërimi i Ramazanit<sup>1</sup>”.*

### **Fikhu i hadithit:**

- 1) Agjërimi është një nga pesë shtyllat e fesë sonë dhe kush e mohon atë, ka mohuar një pjesë të fesë dhe kjo e nxjerr atë person nga feja.
- 2) Agjërimi si adhurim ishte i njohur edhe në periudhën paraislamike si dhe në sheriatet e mëhershme, siç u përmend në fillim në ajetin 183 të kaptinës El Bekare dhe siç tha Aishja, radijAllahu anha: “Kurejshitët e agjëronin ditën e Ashures gjatë injorancës (para Islamit) dhe i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, e agjëronte atëkohë<sup>2</sup>”.
- 3) Sheriati islam nuk ka ardhur me diçka të re, por ka shpjeguar urtësinë e agjërimin. Nuk

---

1 Transmetojnë Buhariu (8) dhe Muslimi (16).

2 Transmeton Buhariu (2002).

është nga urtësia e agjërimit privimi i njerëzve nga dhuntitë e Allahut: ngrënia, pija e marrëdhëniet intime, por urtësia mbi të gjitha është devotshmëria, siç tha Allahu: “që të jeni më të devotshëm<sup>1</sup>”.

- 4) Ata që e përmbajnë veten nga kënaqësitë e tyre duke pasur frikë Allahun për një muaj, patjetër se do t’u ndryshojë rrjedha e jetës, ndaj muaji i agjërimit -për atë që i është dhënë sukses- është një stërvitje e madhe e shpirtit, kalitje e durimit, e devotshmërisë dhe e nënshtrimeve të shumta<sup>2</sup>.

---

1 Uthejmini, rahimehullah (Et Tealiku ala risaleti hakikatis sijam, faqe 12).

2 Po aty, faqe 13.



**5**I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

*“Pesë namazet, xhumaja deri në xhuma dhe Ramazani deri në Ramazan i shlyejnë mëkatet<sup>1</sup> që bëhen mes tyre, nëse shmangen mëkatet e mëdha<sup>2</sup>”.*

**Fikhu i hadithit:**

- 1) Ky hadith tregon për dhuntinë e madhe të Allahut dhe bujarinë e Tij, meqë na ka nderuar me këto tre adhurime, një ndër të cilat është përcjellja e agjërimeve të Ramazanit si pastrim nga mëkatet.
- 2) Dëmet e mëkateve janë të mëdha dhe janë pakësim i besimit, siç dihet.
- 3) Gjithashtu hadithi na mëson qartazi se mëkatet ndahen në të mëdha dhe të vogla. Më e mira që është thënë në përkufizimin e të mëdhave është se pas kryerjes së tyre pasojë vjen ndëshkimi në dynja (kodi penal), ose ka kërcënim për të në ahiret, ose mallkohet vepruesi i tij, ose ka hidhërim nga Allahu e të tjera, kurse të voglat janë më pak se ato<sup>3</sup>.

---

1 E vogla.

2 Transmeton Muslimi (233).

3 Ibën Seadi, rahimehullah, Behxhetu kulubi ebrar, faqe 56, 57.

- 4) Përcjellja e Ramazaneve me agjërim është nga shkaqet e fshirjes së mëkateve e gabimeve. Sa nevojë kemi për fshirjen e mëkateve dhe gabimeve tona, nga të cilat nuk shpëton askush, siç thuhet në hadith autentik: “Çdo bir i Ademit është gabimtar...”<sup>1</sup>
- 5) Meqë agjërimi i Ramazanit i jep muslimanit mundësinë e fshirjes së mëkateve, atëherë ai duhet të jetë gati për pritjen e tij duke i menduar të gjitha mundësitë e mosangazhimit me dynjanë gjatë këtij muaji, në mënyrë që sa ma shumë ta kalojë atë në adhurime, nënshtrime e lexim të Kuranit.
- 6) Fjala e tij, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem: “nëse shmangen mëkatet e mëdha”, aludon se me fshirje ka për qëllim mëkatet e vogla, gjersa mëkatet e mëdha kanë nevojë për pendim<sup>2</sup>.

---

1 Transmeton Tirmidhiu (2499), saktësoi Albani.

2 El Minhaxh (3/118), Neveviu, rahimehullah.

**6**I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

*“Mos agjëroni derisa ta shihni gjysmëhënën e as mos bëni bajram<sup>1</sup>, derisa ta shihni atë. Nëse nuk duket qartë<sup>2</sup>, atëherë përcaktojeni atë<sup>3</sup>”<sup>4</sup>*

### **Fikhu i hadithit<sup>5</sup>:**

- 1) Fillimi i agjërimin dhe përfundimi i tij realizohet përmes shikimit të hënës.
- 2) Pamja e konsiderueshme e pranueshme është ajo e syrit.
- 3) Urdhri në hadith aludon për obligueshmëri.
- 4) Është obligim të plotësohet muaji i shabanit dhe Ramazanit tridhjetë ditë nëse nuk shihet hëna dhe kjo bëhet duke agjëruar tridhjetë ditë.

---

1 Mos e ndërpritni agjërimin e muajit Ramazan.

2 Nga mjegullat apo shirat.

3 Plotësojeni me 30 ditë agjërim.

4 Transmetojnë Buhariu (1906) dhe Muslimi (1080). Muslimi po ashtu: “Nëse mjegullohet (nuk shihet), atëherë plotësojeni tridhjetë (shabanin)”. Buhariu transmeton: “Atëherë plotësojeni muajin me tridhjetë” (1909), si dhe te Buhariu nga Ebu Hurejra: “Atëherë plotësojeni muajin shaban me tridhjetë (ditë)”.

5 Zubdetul e fham, faqe 754.

- 5) Nëse hëna shihet natën, agjërimi fillon nga dita e nesërme, jo nga ajo natë që u pa hëna.
- 6) Nuk duhet të mbështetemi në fjalët e astronomëve për hyrjen e muajit sepse fjala e tyre është e mbështetur në lindjen e hënës së re, kurse agjërimi mbështetet në shikimin e hënës. Shejhul Islami, rahimehullah, ka thënë: “S’ka dyshim se është transmetuar saktësisht nga suneti dhe sahabët se nuk lejohet mbështetja në llogaritjet e yjeve dhe se ai që mbështetet në të është i devijuar në shariat dhe ka sajuar në fe, ka gabuar në logjikën e tij dhe në astronomi<sup>1</sup>.”

---

1 Tevdihul ahkam min bulugil meram (3/450), shejh Abdullah Bessam, rahimehullah.

**7**I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

*“Kur vjen Ramazani, hapen dyert e xhenetit dhe mbyllen dyert e xhehenemit dhe prangosen djajtë<sup>1</sup>”.*

### **Fikhu i hadithit:**

- 1) Në Ramazan hapen dyert e xhenetit. Në një transmetim thuhet “dyert e mëshirës”, e në një transmetim “dyert e qiellit”, por nuk ka kurrfarë kundërshtimi mes tyre meqë dyert e qiellit hapen për t’u ngritur veprat e mira e të shumta në këtë muaj, fjalët e mira gjithashtu me bollëk dhe dyert e mëshirës janë nga shkaqet e hyrjes në xhenet, sepse njerëzit mund të hyjnë në xhenet vetëm me mëshirën e Allahut të Madhëruar e jo me veprat e tyre<sup>2</sup>.
- 2) Mbyllen dyert e zjarrit të xhehenemit për shkak të mëkateve të pakta nga besimtarët<sup>3</sup> dhe vullnetit të tyre për pendim si dhe përma-llimit të tyre për xhenetin<sup>4</sup>.

---

1 Transmetojnë Buhariu (1899) dhe Muslimi (1079).

2 Behxhetun nadhirin (2/362).

3 Uthejmini, rahimehullah (Sherhu Rijadis Salihin, faqe 915, hadithi nr. 1221).

4 Behxhetun nadhirin (2/362).

- 3) Prangosen apo lidhen me zinxhirë shejtanët dhe ka për qëllim kryeneçët në mesin e tyre, siç shihet në hadithin e mëposhtëm. Kryeneçët apo rebelët janë më armiqësorët ndaj njerëzve. Me prangosje ka për qëllim lidhjen e duarve të tyre që të mos bëjnë atë që bëjnë në muajt e tjerë dhe kjo është e vërtetë, siç e ka lajmëruar i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sellem, si këshillë për umetin e vet<sup>1</sup>.
- 4) Me këtë rast në muajin Ramazan pakësohet e keqja në tokë dhe mundësia për t'u prishur njerëzit nga shejtanët armiqësorë është më e vogël<sup>2</sup>, meqë muslimanët janë të preokupuar me agjërim, namaz nate, lexim të Kuranit, zmbropsen e pshet dhe kaliten e pastrohen shpirtrat<sup>3</sup>.
- 5) Kurtubiu, rahimehullah, në "El Mufhim" shkruan: "Nëse thuhet si është e mundur që shohim të këqija dhe mëkate të shumta në Ramazan,

---

1 Uthejmini, rahimehullah (Sherhu Rijadis Salihin, faqe 915).

2 Kadi Ijad, rahimehullah, ka thënë: "Prangosja ndodh që ata të pengohen nga të bërit keq besimtarëve dhe shpërqendrimi i tyre" (El Minhaxhu, 7/188), Neveviu.

3 Behxhetun nadhirin (2/362).

pasi sikur të prangoseshin shejtanët nuk do të ndodhte kjo?, përgjigjja është se në realitet ato pakësohen nga agjëruesit e agjërimit që i ka plotësuar kushtet. Ndoshta të prangosurit janë disa djaj kryeneçë e jo të gjithë, siç është përmendur në disa transmetime, ose qëllimi është zvogëlimi i të keqes në të...”

**8**I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

*“Kur të jetë nata e parë e muajit Ramazan, prangosen djajtë dhe xhinët kryeneçë dhe mbyllen dyert e zjarrit e nuk hapet asnjë derë e saj, ndërsa hapen dyert e xhenetit e nuk mbyllet asnjë derë e saj dhe një thirrës thërret: O kërkues i së mirës, mësyja! Dhe: O kërkues i së keqes, zmbropsu! Dhe Allahu liron nga zjarri. Dhe kjo ndodh çdo natë (të Ramazanit)<sup>1</sup>”.*

### **Fikhu i hadithit:**

- 1) Hapja e dyerve të xhenetit dhe mbyllja e dyerve të xhehenemit ndodh që nga nata e parë e Ramazanit dhe këtë e ndien çdo besimtar që e pret këtë muaj me vlerë.
- 2) Një thirrës nga qielli do të thërrasë dhe në musnedin e Ahmedit përmendet se ai thirrës do të jetë një engjell: “...dhe një engjell nga qielli thërret...”<sup>2</sup>
- 3) Kush ishte neglizhent para këtij muaji, tani dyert e të mirave i ka të hapura, edhe rrugët

---

1 Transmeton Tirmidhiu (682), saktësoi Albani.

2 Musnedi i Ahmedit (18042).



më të lehta, kurse për atë që ishte zhytur në gabime e mëkate, tani është koha e pendimit, e istigfarit dhe e kthimit të sinqertë tek Allahu me veprat e zemrës dhe të gjymtyrëve.

- 4) O ti që ia ke mësyre të mirës, urdhëro e vepro siç bënte Pejgamberi ynë, i cili recitonte pandalshëm Kuran, jepte lëmoshë dhe falte namaze të zgjatura natën, me ruku e sexhde të shumta.
- 5) Nga mëshira e Allahut është se Ai në çdo natë të këtij muaji liron nga zjarri ata që e meritojnë me veprat e tyre të shumta të devotshmërisë.

**9**I Dërguari i Allahut, sal-Allahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

*“Hani syfyr sepse në syfyr ka begati<sup>1</sup>”.*

### **Fikhu i hadithit:**

- 1) Syfyri është pjesë e agjërimit të Ramazanit.
- 2) Syfyri ka vlerë të madhe dhe begati në fe dhe në dunja.
- 3) Begatia e syfyrin është e madhe. Ai është pasim i sunetit dhe kundërshtim i ithtarëve të librit, të forcon dhe të jep fuqi për agjërime, është nga shkaqet e përmendjes së Allahut, lutjes dhe mëshirës sepse është koha e përgjigjes së lutjeve, mund të jetë shkak për të dhënë sadaka në atë kohë për nevojtarët, ta përtërin njetin e agjërimit dhe është shkak për moral të mirë sepse uria mund të jetë shkak i moralit të tij të keq gjatë ditës<sup>2</sup>.
- 4) Mendimi i preferuar është se syfyri është obligim, meqë argumentet aludojnë për këtë realitet. Përpos hadithit në fjalë, ku folja erdhi në formën urdhërore “Hani syfyr”, po ashtu

---

1 Transmetojnë Buhariu (1923) dhe Muslimi (1095).

2 Ibën Mulakkin (5/187).

edhe hadithet: “Dallimi mes agjërimit tonë dhe agjërimit të ithtarëve të librit është ngrënia e syfyrit”<sup>1</sup> dhe hadithi “Bëni syfyr, qoftë edhe me një gllënjë uji”<sup>2</sup>.

- 5) Hadithet ku urdhërohet ngrënia e syfyrit ose nxitet për të apo preferohet vonimi i tij, të gjitha e arrijnë gradën e haditheve mutevatir siç thotë Tahaviu dhe të tjerët<sup>3</sup>.

---

1 Transmeton Muslimi (1096).

2 Sahihul Xhamiu (2001).

3 Tevh dihul ahkam (3/475).

**10**I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

*“Vërtet Allahu i begaton dhe engjëjt luten (tek Allahu) për begati për ata që hanë syfyr<sup>1</sup>”.*

**Fikhu i hadithit:**

- 1) Ky hadith e bën më specifik vlerën e syfyrin dhe atyre që ngrihen për të ngrënë në syfyr, meqë Allahu i begaton, i fal, u jep paqe e rehati.
- 2) Engjëjt i luten Allahut për falje dhe begati ndaj atyre që hanë syfyrin.

---

1 Sahihu et Tergib (1066) dhe Es Sahiha (3409), saktësoi Albani.

**11** I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë:

*“Sa syfyr i mirë i besimtarit është ngrënia e hurmës!”<sup>1</sup>*

### **Fikhu i hadithit:**

- 1) Pejgamberi ynë, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, nuk ka lënë gjë pa na e shpjeguar nga kjo fe, ndër të cilat edhe atë se çështë më e mirë të hahet në syfyr. Pa dyshim se ai ishte besniku që tha të vërtetën sepse **“ai nuk flet sipas dëshirës së vet, por ajo (që thotë) është vetëm shpallje që i vjen atij”<sup>2</sup>**.
- 2) Hurma është ushqimi më i mirë i syfyrin, bile Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, hante hurma për syfyr dhe e kishte zakon, e kur nuk kishte hurma, atëherë pinte disa gllënjka uji<sup>3</sup>.
- 3) Hadithi na mëson se ngrënia e hurmës në syfyr është e preferuar, por kjo nuk do të thotë që nuk lejohet të hamë edhe ushqime të tjera për shkak të haditheve të tjera autentike.

---

1 Sahihu et Tergib (1072).

2 En Nexhm: 3-4.

3 Transmetojnë Tirmidhiu (632), Ebu Davudi (2009), saktësoi Albani.

- 4) Kjo është nga mëshira dhe dhembshuria e madhe që kishte Pejgamberi, alejhi salatu ves selam, ndaj umetit të vet, meqë hurma është fuqizues i madh i mushkërive dhe zbutës i natyrës së njeriut dhe është ndër frutat më ushqyese të trupit, ndaj është ushqim, ilaç dhe ëmbëlsirë<sup>1</sup>.
- 5) Thirrësi për tek Allahu i Madhëruar duhet t'ua lehtësojë njerëzve çështjet e fesë dhe të mendojë për të mirën e tyre, si në rastin e Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, por, kuptohet pa kundërshtuar ligjet e fesë dhe sunetin e tij, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.

---

1 Ibën Kajim, rahimehullah (Et Tibbu en Nebevij) përmes Tevdihul ahkam (3/477).

**12** Nga Irbad ibën Sarije, radijAllahu anhu, transmetohet se ka thënë:

*“I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, më ftoi në syfyr gjatë Ramazanit e më tha: - Eja<sup>1</sup> në ushqimin e begatshëm!”<sup>2</sup>*

**Fikhu i hadithit:**

- 1) Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, po-saçërisht në muajin Ramazanit ishte shumë bujar dhe më i shpejtë në bujari sesa era e fortë<sup>3</sup>.
- 2) Lejohen ftesat dhe bashkimi për të ngrënë së bashku në syfyr e jo vetëm në iftar.
- 3) Ushqimi i syfyrin në hadith u quajt “el gadau” dhe kështu quhet shujta që hahet në mëngjes, sepse e ka zënë vendin e mëngjesit<sup>4</sup>.
- 4) Është quajtur shujtë e mëngjesit sepse agjëruesi forcohet me të gjatë ditës për agjërime dhe konsiderohet sikur të ketë ngrënë mëngjes. Arabët thonë se filani hëngri mëngjes për

---

1 Bashkohu me ne!

2 Sahih Ebu Davud (2344).

3 Transmetojnë Buhariu (6) dhe Muslimi (2038).

4 Avnul meabud (4/428), Ebi Tajib El Adhim Abadi, rahimehullah.

shkak se kishte nevojë, kur dikush ha herët,  
që nga koha e syfyrit deri në kohën e lindjes  
së diellit<sup>1</sup>.

---

1 El Hatabi, rahimehullah.



**13** Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

*“Kur dikush prej jush dëgjon thirrjen<sup>1</sup>, ndërsa ena (me ushqim) është në dorën e tij, mos ta lërë atë derisa ta përfundojë nevojën e tij”<sup>3</sup>*

**Fikhu i hadithit:**

- 1) Me ezan ka për qëllim ezanin e vërtetë të sabahut, jo atë që thirret për të lajmëruar kohën e syfyrit, respektivisht fillimin e syfyrit.
- 2) Në kohën e Pejgamberit, alejhis salatu ves selam, ezani thirrej dy herë, siç transmetohet nga Ibën Umeri se i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, kishte dy muezinë, Bilalin dhe Ibën Umi Mektumin. I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: *“Vërtet Bilali e thërret ezanin natën, kështu që ju hani dhe pini derisa ta thërrasë ezanin Ibën Umi Mektumi”<sup>4</sup>*.
- 3) Hadithi na mëson se agimi është dy llojesh, agimi i rrejshëm dhe ai i vërteti. Agimi i rrej-

---

1 Ezanin e sabahut.

2 Derisa ta përfundojë ushqimin e tij.

3 Sahihu Ebu Davud (2350), Albani.

4 Transmetuan Buhariu (2/99) dhe Muslimi (1092).

shëm nuk na e ndalon ushqimin, por ai i vërteti po dhe ky është për qëllim në hadithin e mësipërm. Transmetohet nga Ibni Abasi se i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: “*Agimi është dy llojesh. Sa i përket të parit, ai nuk e ndalon ushqimin e as nuk e lejon namazin<sup>1</sup>, ndërsa i dyti e ndalon ushqimin dhe e lejon namazin<sup>2</sup>*”.

- 4) Hadithi na mëson se syfyri duhet shtyrë sa ma shumë dhe jo të hahet para kohe, siç veprohet sot në shumë vende islame dhe për pasojë muslimanët e falin para kohe pastaj edhe namazin e farzit të sabahut. Ibën Haxheri, rahimehullah, ka thënë: “Nga bidatet e sotme është thirrja e ezanit të sabahut para kohës së tij për një të katërtën e orës në Ramazan dhe fikja e qirinjve si shenjë e ndalimit të ngrënies dhe pirjes për agjëruesit, me pretekstin se këtë e kanë sajuar si rezervë në adhurim... Kështu ata e përshpejtuan syfyrin dhe kundërshtuan

---

1 Nuk tregon për kohën e hyrjes së namazit.

2 Transmetojnë Ibën Huzejme, Hakimi, Darekut-niu, Bejhakiu dhe të tjerët me sened të saktë (Behxhetun Nadhirin, 2/370).

sunetin, ndaj edhe tek ata u pakësua e mira e u shtua e keqja, Allahu qoftë në ndihmë!”<sup>1</sup>

- 5) Nga mëshira e Allahut është që edhe nëse e dëgjojmë ezanin e sabahut dhe ushqimi ynë është në dorën tonë, Ai na e lejoj të hamë derisa ta përfundojmë atë ushqim<sup>2</sup> dhe kjo nuk e prish agjërimin tonë.
- 6) Fjala e Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ve sellem, “derisa ta përfundojë ushqimin e vet”, është kur ai e di apo ka menduar se akoma nuk është bërë agim<sup>3</sup>.

---

1 Feth’ul bari (4/199).

2 Alij el Karij, rahimehullah (Avnul meabud, 4/432).

3 Po aty.

**14** Nga Zejd ibën Thabiti, radijAllahu anhu, transmetohet se ka thënë:

“Hëngrëm syfyr me Pejgamberin, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, pastaj ai u ngrit për namaz”. Dhe unë<sup>1</sup> i thashë: -Sa kishte mes ezanit dhe syfyrin? Ai tha: -*Sa leximi i pesëdhjetë ajeteve*<sup>2</sup>”.<sup>3</sup>

### **Fikhu i hadithit:**

- 1) Preferohet vonimi i syfyrin deri në daljen e agimit të vërtetë, që është nga sunetet e braktisura, e i lumtë atij që e ringjall.
- 2) Edukata e mirë me të moshuarit, meqë Zejdi tha: “Hëngrëm syfyr me Pejgamberin”, e nuk tha “ai hëngri me ne”. Pra, sikur tha se kishim nderin të hanim me të, e jo e kundërta.

---

1 Enesi, transmetuesi që e dëgjoi hadithin nga Zejdi (Fet’hul bari, 5/625, Ibën Haxheri).

2 Ibën Haxheri tha: “Pra, ajete të mesme e jo të gjata, e as të shkurtra, as me lexim të shpejtë e as të ngadaltë... Zejd ibn Thabiti e përcaktoi kohën (mes fillimit të syfyrin dhe ezanit të dytë, agimit të vërtetë) me lexim të Kuranit, duke bërë me dije se ajo kohë ishte kohë e adhurimit me lexim (Fet’hul bari, 5/626).

3 Transmetojnë Buhariu (1921) dhe Muslimi (1097).

- 3) Kujdesi për të kërkuar dije dhe për t'i shoshitur mirë çështjet, për t'i ndjekur sunetet dhe për t'i mësuar ato.
- 4) Pëlqehet bashkimi në syfyr.
- 5) Lejohet përcaktimi i kohës së syfyrin me leximin e ajeteve të Kuranit ose me ndonjë lloj tjetër adhurimi.
- 6) Hadithi na mëson se koha e sahabëve ishte e mbushur me adhurime, ndaj duhet shfrytëzuar koha në atë që i bën dobi në dunja dhe në ahiret<sup>1</sup>.
- 7) Koha e ndaljes nga ushqimi në syfyr është kur del agimi i vërtetë, siç thotë Allahu i Lartësuar: **“Dhe hani e pini derisa të dallohet fija e bardhë (*bardhësia*) e agimit nga fija e zezë (*errësira e natës*)”** (El Bekare: 187). Me këtë e dimë se ndarja që kanë bërë njerëzit në dy kohë, koha për imsak (përfundimi i ngrënies) dhe koha për daljen e agimit, është bidat për të cilin Allahu nuk ka zbritur dije, por është cytje nga shejtani për t'ua mbështjellë atyre fenë, përndryshe suneti i Muhamedit është që përfundimi i ngrënies është me daljen e agimit të vërtetë<sup>2</sup>.

---

1 Zubdetul eham, faqe 760-761, El Hilalij.

2 Tejsirul Al-lam (1/415), shejh Abdullah el Bessam,

# 15 Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

*“Kush nuk e ka bërë nijet agjërimit para agimit,  
nuk ka agjërim për të<sup>1</sup>”.*

## **Fikhu i hadithit:**

- 1) Hadithi aludon për obligueshmërinë e nijetit për agjërimitin e Ramazanit, sipas konsensusit të dijetarëve.
- 2) Vendi i nijetit është zemra, ndaj atij që i shkon në mendje se nesër ka për të agjëruar, ai e ka bërë nijetin dhe mjafton ngrënia e pirja e tij në syfyr si nijet i agjërimit<sup>2</sup>.
- 3) Ibën Tejmije, rahimehullah, ka thënë se nëse muslimani e bën nijet ta agjërojë Ramazanin në fillim të muajit, i mjafton për tërë muajin<sup>3</sup>. Shejh Uthejmini, rahimehullah, ka thënë: “E

---

rahimehullah.

1 Sahih Ebi Davud (2454).

2 Tevdihul ahkam (3/465).

3 Imam Is’hak ibën Rahavejhi, rahimehullah, ka thënë: “Nëse dikush e bën nijetin për muajin që nga nata e parë, i pranohet për tërë muajin edhe nëse nuk e ripërtërin nijetin çdo natë”. Avnul Meabud, 4/534.

sakta është se për Ramazan kushtëzohet nijeti vetëm në natën e parë, kurse netët tjera e përcjellin atë<sup>1</sup>”.

---

1 Et Tealiku ala kitabis sijam minel furui, faqe 173.

## 16 Nga Aishja dhe Umi Seleme, radij-Allahu anhumâ, transmetohet se:

“të Dërguarin e Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, e rastiste agimi duke qenë xhunub<sup>1</sup> (nga marrëdhëniet intime) me gruan e vet, pastaj lahej dhe agjëronte<sup>2</sup>”.

### **Fikhu i hadithit:**

- 1) Kush zgjohet xhunub nga marrëdhëniet me gruan ose nga ëndrrat natën, e ka agjërimin e saktë, nuk i prishet.
- 2) Nuk është obligim të nxitosh për gusël menjëherë pas xhenabetit.
- 3) Lejohen marrëdhëniet intime me gruan gjatë netëve të Ramazanit.
- 4) Vlera e grave të Pejgamberit tonë, meqë na kanë transmetuar sunetet e tij.
- 5) Vepra e Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, është argument dhe ligj për umetin.

---

1 I palarë me gusël pas marrëdhënieve.

2 Transmetojnë Buhariu (1925) dhe Muslimi (1109).



**17** Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

*“Kush agjëron një ditë për hir<sup>1</sup> të Allahut, Allahu e bën një hendek mes tij dhe mes zjarrit sa distanca mes qiellit dhe tokës<sup>2</sup>”.*

**Fikhu i hadithit:**

- 1) Nxitja profetike për të shtuar agjërimin vullnetar për shkak të dobive të mëdha në dunja dhe ahiret.
- 2) Rëndësia e nijetit në agjërim, që të jetë për Allahun e Madhëruar.
- 3) Agjërimi të ruan nga zjarri i xhehenemit në Ditën e Kiametit.
- 4) Nëse dëshiron që në ahiret ta kesh zjarrin sa më larg teje, atëherë mos ji neglizhent ndaj agjërimit vullnetar!

---

1 Në rrugë të Allahut.

2 Es Silsile es Sahiha (563).

# 18 Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

*“Kush e agjëron një ditë në rrugë të Allahut<sup>1</sup>, Allahu ia largon atij fytyrën nga zjarri (xhehe-nemit) për shtatëdhjetë vjeshta<sup>2</sup>”<sup>3</sup>*

## **Fikhu i hadithit:**

- 1) Vlera e agjërimit nafle për hir të Allahut të Lartësuar.
- 2) Atë që nuk e dobëson agjërimi nga lufta në rrugë të Allahut, ai bën bashkimin e të dyjave.
- 3) Është veçuar në hadith përmendja e vjeshtës, meqë kjo është stina më e shijshme sepse vilen fruta të ndryshme<sup>4</sup>.
- 4) Numri i përmendur në hadith nuk ka ndonjë kuptim, por është përmendur për të treguar diçka të madhe dhe për ta sqaruar më mirë, meqë ai që shpëton nga zjarri veçse ka hyrë në xhenet<sup>5</sup>.

---

1 Për Allahun e lartësuar.

2 Vite.

3 Transmetojnë Buhariu (2840) dhe Muslimi (1153).

4 Behxhetun Nadhirin (2/361).

5 Tevdihul ahkam (3/536), Abdullah Bessam, rahi-mehullah.

- 5) Nga kohët më të mira për të bërë agjërime vullnetar është stina e dimrit, meqë i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: “Agjërimi në dimër është plaçka e ftohtë<sup>1</sup>”.

---

1 Es Sahiha (1992), nga Ibni Mesudi, e saktësoi Albani.

# 19 Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

*“Kush e agjëron Ramazanin me besim dhe duke shpresuar shpërblimin, atij i falen gjynahet e mëparshme”<sup>1,2</sup>*

## **Fikhu i hadithit:**

- 1) Hadithi sqaron vlerën e Ramazanit dhe pozitën e tij të lartë në krahasim me muajt e tjerë.
- 2) Kush e agjëron Ramazanin, i falen gabimet dhe mëkatet e kaluara, edhe nëse janë sa shkuma e detit.
- 3) Me besim agjëron ai që beson se agjërimi i Ramazanit është obligim prej Allahut e jo të agjërojë për adet apo sepse të gjithë njerëzit po agjërojnë.
- 4) Duke shpresuar shpërblimin ka për qëllim fitimin e shpërblimit të agjërimit që Allahu ka caktuar për agjëruesit, por vetëm Ai e di sasinë e tij.
- 5) Me këto dy cilësi agjëruesi vërteton se është duke agjëruar me plot dëshirë e me kënaqësi,

---

1 Të kaluara.

2 Transmetojnë Buhariu (2014) dhe Muslimi (760).

jo me zor. Atij nuk i vjen rëndë nga agjërimi e as nga ditët e shumta dhe të gjata të verës.

**20** Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

*“Agjërimi është mbrojtje dhe kështjellë e mbrojtur nga zjarri<sup>1</sup>”.*

### **Fikhu i hadithit:**

- 1) Agjërimi është mbulesë, perde, pengesë mes agjëruesit dhe zjarrit.
- 2) Agjërimi është mbrojtje dhe pengesë mes agjëruesit dhe epsheve, sepse i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: *“O ju të rinj, kush prej jush i ka mundësitë, le të martohet, e kush nuk ka mundësi, atëherë le të agjërojë, sepse ai (agjërimi) është mbrojtje<sup>2</sup>”.*
- 3) Agjërimi –sipas një transmetimi- të mbron nga zjarri, ashtu siç mbrohet dikush nga vrasja<sup>3</sup>.
- 4) Ebu Zurah, rahimehullah, ka thënë se nga hadithet e shumta që thonë se agjërimi është mbrojtje është nxjerrë si përfundim nga shumica se agjërimi është adhurimi më i mirë

---

1 Sahihul Xhamiu (3880), Albani.

2 Transmetojnë Buhariu (5065) dhe Muslimi (1400).

3 Transmetojnë Ibën Ebi Shejbe (3/4), Ahmedi (4/21) Ibën Maxheh (1639) dhe të tjerët, e saktësoi Albani.

trupor në mënyrë absolute, përpos Shafiut, i cili ka thënë se namazi është adhurimi trupor më i mirë<sup>1</sup>.

---

1 Fajdul kadir (4/328), El Munavi, rahimehullah.

**21** Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë se “Allahu ka thënë:

*“Çdo vepër e birit të Ademit i takon atij, përpos agjërimit, ai është vetëm për Mua dhe vetëm Unë! shpërblej për të”.*

### **Fikhu i hadithit:**

- 1) Hadithi në fjalë është hadith kudsij, ngase i Dërguari i Allahut, alejhi salatu ves selam, ka transmetuar drejtpërdrejt te ne fjalën e Allahut të Madhëruar dhe ky është dallimi mes tij dhe hadithit të rëndomtë, kurse dallimi mes hadithit kudsij dhe fjalëve të Allahut në Kuran është se për leximin e fjalëve të Allahut në Kuran njeriu shpërblehet për çdo shkronjë dhjetë sevape, kurse për fjalët e hadithit kudsij jo.
- 2) Të gjitha veprat e besimtarit shpërblehen nga dhjetë deri në shtatëqind sevape, siç thuhet në një transmetim tjetër<sup>3</sup> të këtij hadithit, përpos agjërimit, shpërblimi për të nga Allahu ka tjetër vlerësim.

---

1 Vetëm Unë e di se sa shpërblej për të!

2 Transmetojnë Buhariu (1904) dhe Muslimi (1151), ky hadith konsiderohet si hadith kudsij në shkencën e hadithit.

3 Tra.Buhariu (1894) dhe Muslimi (1151).



- 3) Fjala e Tij, qoftë i lavdëruar, “përpos agjërimit, ai është vetëm për Mua”, tregon se Allahu e ka veçuar agjërimit për Vete, duke ia referuar Vetes së Tij, çka aludon për vlerën e madhe të agjërimit dhe peshën e madhe të tij në Ditën e Gjykimit.
- 4) Se sa do të jetë shpërblimi i agjërimit, këtë e di vetëm Allahu i Madhëruar dhe askush tjetër. Kjo tregon për mëshirën e madhe të Allahut ndaj krijesave të Tij.
- 5) Hadithi është një këshillë e madhe dhe nxitëse për ata që i ka mashtruar shejtani dhe ende nuk agjërojnë apo agjërojnë pjesërisht e janë neglizhent ndaj kësaj mirësie të madhe të Allahut, për të cilën do të kenë nevojë shumë në Ditën e Gjykimit, atë ditë kur nuk të bën dobi askush dhe asgjë, përpos veprës së mirë, e agjërimi është ndër veprat më të mira.
- 6) Në një transmetim tjetër shpjegohet urtësia pse Allahu i Madhëruar ia ka referuar agjërimit e robit Vetes. Në të thuhet: “*E ka lënë epshin e tij, ushqimin e tij, pijen e tij për shkakun Tim*”. Pa dyshim se në këtë rast Allahu do që t’ia shpërblejë njeriut këtë sakrificë në formën më të mirë dhe me premisat më sublime.

- 7) Ibën Rexhebi, rahimehullah, ka thënë se nga urtësitë është po ashtu se agjërimi është një sekret i madh mes njeriut dhe Zotit, askush nuk e di fshehtësinë e tij sepse ka të bëjë me një qëllim të brendshëm që nuk e di askush përveç Allahut, prandaj është thënë se nuk ka syfaqësi në të<sup>1</sup>.

---

1 Letaiful mearif fq.290, Ibn Rexheb el Hanbelij, rahimehullah.

**22** Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

*“Agjërimi dhe Kurani ndërmjetësojnë për njeriun në Ditën e Kiametit. Agjërimi thotë: -O Zot, unë e kam penguar atë nga ushqimi dhe epshet gjatë ditës, andaj më prano si ndërmjetësues për të. Kurani thotë: -O Zot, unë e kam penguar nga gjumi gjatë i natës, andaj më prano si ndërmjetësues për të. Atëherë ata të dy ndërmjetësojnë<sup>1</sup>”<sup>2</sup>*

### **Fikhu i hadithit:**

- 1) Përgëzim për agjëruesin se agjërimi i tij do të ndërmjetësojë tek Allahu për të, e ky duhet të jetë motiv që besimtari të kënaqet me agjërimitin e tij.
- 2) I njëjti përgëzim është edhe për lexuesin e Kuranit, posaçërisht në muajin Ramazan, meqë konsiderohet edhe muaji i Kuranit, sepse në të filloi zbritja e tij, siç thotë Allahu në Kuran: **“Muaji Ramazan, që në të (filloi**

---

1 Pranohen nga Allahu si ndërmjetësues për lexim të Kuranit dhe agjërimit, e sa përgëzim dhe stimulim i madh është kjo për besimtarin.

2 Sahihul Xhamiu (3882).

të) **shpallet Kurani**”<sup>1</sup> dhe se Muhamedi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, e lexonte Kuranin në Ramazan së bashku me Xhibrilin, alejhi salatu ves selam, çdo natë<sup>2</sup>.

- 3) Njerëzit e devotshëm përgëzohen që në këtë dunja dhe qetësohen për devotshmërinë e tyre. Nga elementet më të çmuara të devotshmërisë është leximi i librit të Allahut dhe agjërimi për të si sakrificë sublime, siç thotë Allahu: **“Ata që i binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij, që kanë frikë Allahun dhe i përkushtohen Atij, do të jenë të fituarit e vërtetë”**<sup>3</sup>.
- 4) Njeriu shok më të mirë ka veprën e tij të mirë për Allahun e Madhëruar, vetëm ajo do të ndërmjetësojë në Ditën e Kiametit, kurse të gjithë të tjerët do të ikin nga ti, secili do të shikojë shpëtimin për veten: **“Atë ditë njeriu ikën prej vëllait të vet. Prej nënës dhe prej babait të vet. Prej gruas dhe prej fëmijëve të vet. Atë ditë secilit njeri i mjafton çështja e vet”**<sup>4</sup>. O rob i Allahut, mos e humb kohën

---

1 El Bekare: 185.

2 Transmetojnë Buhariu (1/30) dhe Muslimi (2307).

3 En Nur: 52.

4 Abese: 34-37.

në punë të kota e të padobishme, por puno për të ardhmen tënde të pashmangshme, ditën e llogarisë para Allahut të Lartësuar!

- 5) Aspiratat e larta dhe gradat e mëdha nuk arrihen pa sakrifica dhe vështirësi qoftë mendore apo trupore, sepse agjërimi atë ditë do të thotë: “E kam privuar nga ushqimi dhe epshet gjatë ditës”, kurse Kurani do të flasë për ty e do të thotë: “E kam privuar nga gjumi natën”.
- 6) Dijetarët kanë përmendur se me rritjen e vështirësive në kryerjen e urdhrave të Allahut rriten edhe shpërblimet tek Ai dhe gradat, sikur abdesti me ujë të ftohtë në dimër që pastron mëkatet.
- 7) Vetmia e besimtarit në thellësinë e natës ka peshën e vet dhe shpërblimin e madh si dhe është shenjë e njerëzve të dalluar, siç është përmendur në shumë vende në Kuran dhe në hadithe profetike autentike<sup>1</sup>.
- 8) Ndërmjetësimi me vepra është mëshirë e Allahut për umetin e Muhamedit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, dhe besimtari për këtë duhet ta falënderojë Allahun e Madhëruar.

---

1 Rreth vlerës së namazit të natës lexo librin e Imam Axhurrit, rahimehullah, “Vlera e namazit të natës”, të botuar së fundmi në gjuhën shqipe nga shtëpia botuese “Sira”, Prishtinë.

**23** Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

*“Është nënçmuar dhe ka humbur ai njeri që ka arritur Ramazanin dhe përfundoi<sup>1</sup> para se atij t'i falen mëkatet”<sup>2</sup>*

**Fikhu i hadithit:**

- 1) Kur të afrohet Ramazani, kujdes nga kurthet e shejtanit me punët e dunjasë, mos i hap vetes punë të dunjasë sepse ato degëzohen e kur degëzohen, të privojnë nga adhurimet e nënshtrimet plot premisa të këtij muaji.
- 2) Qëllimi i agjërimit të Ramazanit përveç arritjes së devotshmërisë është edhe falja e mëkateve nga Allahu, Falësi, Mëshiruesi. Allahu i Madhëruar në Kuran e thotë qartazi këtë: **“A nuk dëshironi që Allahu t’ju falë?”**<sup>3</sup>
- 3) Ramazani është shansi i besimtarit për përmirësimin e raporteve me Zotin e vet, ngase agjërimi i përkryer të afron tek Allahu, e afrimi tek Allahu nënkupton kujdes të veçantë prej Tij për ty.

1 Shkoi muaji e atij nuk iu falen mëkatet (Tuhfetul ahvedhi, Mubarekfuri, faqe 2501).

2 Transmeton Tirmidhiu (3545), e saktësoi Albani.

3 En Nur: 22.

- 4) Kujdes nga shkujdesja me ndeja të kota në këtë muaj të rëndësishëm për shpëtimin Tënd, sepse nuk ka gjë më të rëndësishme për ty sesa shpëtimi në ahiret, synim kryesor i besimtarit në këtë dunja, por ja që ky shpëtim nuk arrihet pa vigjilencë dhe përpjekje maksimale.
- 5) Përpos agjërimit dhe ndaljes së epshit, shiko edhe përmirësimin e gjuhës tënde, sepse kjo është një nga arsyet e arritjes së faljes së Allahut dhe kënaqësisë së Tij.
- 6) Bëhu i mirë me anëtarët e familjes, me prindërit, me gruan e fëmijët, me fqinjin, me skamnorin e të varfrin, me të sprovuarit e me jetimët, lutu për veten dhe të vdekurit e tu, mos i harro edhe shokët e vëllezërit e tu të fesë, hoxhallarët e kërkuesit e dijes, të gjitha këto janë dyer të bamirësisë me të cilat mund ta arrish faljen e Allahut.

## 24 Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sellem, ka thënë:

*“Në xhenet është një derë të cilës i thuhet Rejan, nga aty hyjnë agjëruesit në Ditën e Kiametit dhe askush tjetër nuk hyn aty përveç tyre<sup>1</sup>”.*

### **Fikhu i hadithit:**

- 1) Xheneti ka dyer të ndryshme dhe secili do të hyjë në to varësisht nga adhurimi që i është lehtësuar atij në dunja, por agjëruesit kanë një derë të veçantë në xhenet, e cila quhet Rejan.
- 2) Mëshira e madhe e Allahut të Madhëruar me agjëruesit, meqë jo vetëm që i ka veçuar agjëruesit me atë derë të xhenetit, por edhe ua ka emërtuar atë derë, që ata të ndihen më të privilegjuar nga të tjerët, për shkak të sakrificës së madhe të tyre trupore në dunja.
- 3) Askush tjetër nuk do të mund të hyjë nga ajo derë, përpos agjëruesve, si shenjë e tyre e veçantë dhe siguri në atë ditë të frikshme, kur agjëruesit janë të siguar nga Allahu i Lartësuar.

---

1 Transmetojnë Buhariu (1896) dhe Muslimi (1152).



- 4) Në këtë hadith është thënë “në xhenet” për t’i mallëngjyer besimtarët me xhenetin dhe për të shtuar kurajën se çfarë do të ketë në atë vend nga të mirat e Allahut për agjëruesit.
- 5) Në një transmetim tjetër<sup>1</sup> agjëruesit do të kenë edhe një privilegj tjetër, sepse ata do thirren nga dera e Rejanit si agjërues, e kjo do të jetë një nder i madh për ta në xhenet.

---

1 Transmetojnë Buhariu (1897) dhe Muslimi (1027)

## 25 Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

*“Aroma e pakëndshme e gojës së agjëruesit është më e mirë tek Allahu sesa aroma e miskut<sup>1</sup>”.*

### **Fikhu i hadithit:**

- 1) Njësia matëse tek Allahu i Madhëruar e që të afron tek Ai është ajo që është mbjellë në zemër dhe reflekton në veprat tona, edhe nëse në shikim të parë mund të duket e pakëndshme, si aroma e pakëndshme që del nga goja e agjëruesit si pasojë e stomakut të zbrazët nga agjërimi për Allahun. Nuk është pamja e luksit dhe aromat e shtrenjta që mund të vërë njeriu, kurse zemra e tij është e zbrazët dhe si pasojë s’ka reflektim devotshmërie në gjymtyrët e tij.
- 2) Sikur Allahu i Madhëruar po u thotë agjëruesve: Duroni edhe nëse dikush nga jobesimtarët, munafikët e injorantët mund të tallen me agjërimin e juaj, sepse **“Ajo që gjendet tek Allahu është më e mirë dhe e përjetshme<sup>2</sup>”**.

1 Transmetojnë Buhariu (1904), Muslimi (1151) dhe Nesaiu (2212), saktësoi Albani.

2 Esh Shura: 36.

- 3) Ndoshta një gjë e urryer te njerëzit është e dashur tek Allahu i Lartësuar dhe e kundërta<sup>1</sup>.
- 4) Allahu i Lartësuar i do besimtarët vepërmirë dhe tek Ai është e rëndësishme vepra e mirë vetëm, ndaj tha: “*më e mirë tek Allahu*” dhe “**bëni mirë, se me të vërtetë Allahu i do vepërmirët**”<sup>2</sup>, si dhe “**vërtet Allahu i do ata që janë të devotshëm**”<sup>3</sup>.

---

1 Ibën Kajimi, rahimehullah (Vabilus sajjib).

2 El Bekare: 195.

3 Alu Imran: 76.

## 26 Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

*“Vërtet Allahu i Lartësuar për çdo ditë e natë liron robër (nga zjarri)<sup>1</sup>, secili prej tyre e ka lutjen e pranuar<sup>2</sup>”.*

### **Fikhu i hadithit:**

- 1) Mirësitë e Allahut të Madhëruar dallojnë ndaj robërve të Tij në dunja dhe në ahiret.
- 2) Muaji Ramazan ka veçoritë e veta pasi të mirat e Allahut shtohen ndaj robërve të Tij.
- 3) Allahu në Ramazan me mëshirën e Tij liron apo nxjerr nga zjarri njerëz pasi ishin bërë robër të mëkateve të tyre.
- 4) Allahu i Madhëruar i vëzhgon robërit e Tij në këtë muaj dhe si bujari nga Ai këtë lirim të tyre nga zjarri e bën çdo ditë e natë, ndaj o rob i Allahut, ji i kujdesshëm në këtë muaj me nënshtime e adhurime dhe meritoje këtë mëshirë e bujari të madhe të Allahut! Allahu na bëftë nga të liruarit e Tij!

---

1 Në Ramazan pra..

2 Sahihul Xhamiu (2169) dhe Sahihut Tergib (1002), Albani.

- 5) O agjërues i Ramazanit, tani ke një shans të madh, lutja jote është e pranuar, shfrytëzoje në maksimum, mos të të ikë koha në çështje të dunjasë e të harrosh lutjen për veten e familjen tënde! Këtë mundësi e ke gjatë tërë Ramazanit, natën e ditën, ti je në adhurim të vazhdueshëm, je edhe më afër Allahut, dhe Allahu turpërohet t'ia kthejë duart e ngritura bosh robit të Vet<sup>1</sup>.
- 6) Veçori e Ramazanit është adhurimi e ndër adhurimet kyçe në këtë muaj të begatshëm është lutja, përgjërimi në lutje dhe shtrimi i kërkesave tek Ai që pret nga ti t'i paraqitësh nevojat e tua.

---

1 Transmetojnë Tirmidhiu (3556) dhe Ibn Maxheh (3131), e saktësoi Albani.

**27** Pejgamberi, alejhis salatu ves selam, ka thënë:

*“Vërtet Allahu në çdo iftar liron robër nga zjarri dhe kjo ndodh çdo mbrëmje<sup>1</sup>”.*

**Fikhu i hadithit:**

- 1) Nga mirësitë e Ramazanit është falja e mëkateve, lirimi nga zjarri dhe mbikëqyrja e Allahut e veçantë ndaj robit në këtë muaj.
- 2) Agjëruesi me çdo kusht duhet të jetë i gatshëm në kohën e iftarit, të mos angazhohet me asgjë tjetër veçse me lutje përgjëruese për të fituar lirim nga zjarri.
- 3) Koha e lutjeve ka peshë të madhe për pranimin e tyre, ndaj edhe muslimani duhet t'i mësojë ato ashtu siç janë përmendur në hadithet e sakta.

---

1 Sahihul Xhamiu (2170), Albani, hadith hasen.

**28** Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sellem, ka thënë:

*“Pa dyshim se agjërimi nuk është vetëm abstenim nga ngrënia dhe pija, por agjërimi është (abstenim) edhe nga fjalët e kota dhe banale<sup>1</sup>”.*

### **Fikhu i hadithit:**

- 1) Hadithi e bën më të fortë qëllimin e agjërimin që ka përmendur Allahu në ajetin e obligueshmërisë së agjërimin të Ramazanit: **“që të jeni më të devotshëm”<sup>2</sup>**.
- 2) Nuk i mjafton njeriut vetëm abstenimi nga epshet kryesore, ushqimi, pija dhe marrëdhëniet intime, por ai duhet ta ruajë edhe gjuhën e vet, sepse qëllim i agjërimin është edhe ruajtja e gjuhës nga mëkatet e saj.
- 3) Ruajtja e gjuhës nga të metat e saj është shenjë se agjëruesi e ka kuptuar drejt konceptin e agjërimin për Allahun e Lartësuar.
- 4) Edhe fjalët e kota, pa kurrfarë dobie duhen shmangur në Ramazan, e ku ka kohë agjëruesi në këtë muaj të begatshëm ta humbë atë me

---

1 Sahihul Mevarid (741).

2 El Bekare: 183.

fjalë të kota të dunjasë?! Sepse ai duhet ta mbushë atë me lexim të Kuranit, përmendje të Allahut dhe lutje të pandërprera e hajrate të tjera të ndryshme.



**29** Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

*“Kush nuk e lë gënjeshtëren dhe punën me të, Allahu nuk ka nevojë që ai ta lërë ushqimin dhe pijen e tij”<sup>1</sup>.*

**Fikhu i hadithit:**

- 1) Gënjeshttra për muslimanin është e ndaluar në çdo kohë, por në Ramazan ia dëmton shumë agjërimin e tij, ia zbeh e pakëson shpërblimet.
- 2) Përkujtoje veten o agjërues me fjalën e Allahut në Kuran për gënjeshtëren dhe punën me të: **“Mallkuar qofshin gënjeshtarët!”**<sup>2</sup>. E ku ka sprovë më të madhe për agjëruesin sesa gënjeshttra dhe puna me të?!
- 3) Sipas hadithit agjëruesi ka dy zgjidhje, ose do ta bëjë agjërimin e tij denjësisht siç e ka kërkuar Allahu prej tij, ose bilanci në fund të muajit do të jetë fatal për të, ashtu si na paralajmëroi i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem: *“Ndoshta agjëruesi nuk ka fituar nga agjërimi i tij vetëm se uri”*<sup>3</sup>.

1 Transmeton Buhariu (1903).

2 Edh Dharijat: 10.

3 Transmeton Ibën Maxheh (1690). Albani tha se

- 4) Mos e kupto gabimisht hadithin sikur Allahu paska nevojë për agjërimin tonë apo për ndonjë vepër tonën të mirë! Assesi, Allahu i Madhëruar na e ka bërë të qartë këtë në shumë vende në Kuran dhe hadithe të sakta. Ai në Kuran thotë: **“Nëse bëni mirë, bëni për vete, e nëse bëni keq, bëni kundër vetes”**. Allahu thotë në hadithin kudsij: *“O robërit e Mi, ju nuk mundeni të më bëni Mua ndonjë dobi edhe nëse i pari i juaj deri tek i fundit nga njerëzit e xhinët të tuboheshin në zemrën e një personi, kjo nuk do të shtonte asgjë në sundimin Tim<sup>2</sup>”,* por:
- 5) Qëllimi i Allahut të Madhëruar është që ne të triumfojmë me shpërblime dhe premisa, e mos ta përziejme adhurimin tonë me gjëra që na i pakësojnë shpërblimet apo edhe na i tretin fare.
- 6) Ndalesa në hadith, përpos gënjeshtërisë në Ramazan, përfshin edhe dëshminë e rrejshme, betimet e rrejshme, shpifjet, përgojimet e bartja e fjalëve, të cilat ta zbehin agjërimin dhe të falimentojnë.

---

hadithi është hasen sahih.

1 El Isra: 7

2 Transmeton Muslimi (2577).

## 30 Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

*“Kur të jetë dita e agjërimit për dikë nga ju, atëherë mos të flasë fjalë banale e as mos të çirret (të piskatë) dhe nëse dikush e shan apo e ngacmon, le të thotë unë jam agjërueshëm<sup>1</sup>”.*

### **Fikhu i hadithit:**

- 1) Agjëruesi duhet ta stërvitë dhe edukojë veten në nënshtrime dhe të adoptohet në bartjen e bezdisjeve për hir të kënaqësisë së Allahut.
- 2) Duhet të mësohet njeriu të ndalet para haramëve dhe mos t'i kalojë kufijtë.
- 3) Nuk është edukatë e agjëruesit piskama dhe të bërtiturit para njerëzve, e sidomos me anëtarët e familjes gjatë Ramazanit.
- 4) Lejohet të tregohet se je duke praktikuar një nënshtrim apo adhurim nëse e kërkon nevoja ose lypset largimi i ndonjë të keqeje apo dëmi<sup>2</sup>

---

1 Transmetojnë Buhariu (1904) dhe Muslimi (1151).

2 Behxhetun nadhirin (2/358).

# 31 Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

*“Fute ujin thellë në hundë<sup>1</sup>, por jo nëse je agjërueshëm<sup>2</sup>”.*

## **Fikhu i hadithit:**

- 1) Nga sunetet e rëndësishme të abdestit është edhe futja e ujit deri në brendi të hundës thellë, saqë mund ta ndiesh edhe djegien në brendi.
- 2) Përjashtim nga kjo bën kur je agjërueshëm nga frika se mund të arrijë në gjoks e të bëhet shkaktar për ta prishur agjërimin.
- 3) Agjëruesi duhet ta ruajë agjërimin e vet dhe kjo arrihet duke i mësuar sunetet e Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, dhe dispozitat e agjërimin.
- 4) Agjëruesi duhet të ketë kujdes të madh nga çdo që ia prish agjërimin e tij. Nëse nuk i di gjërat që ia prishin agjërimin, atëherë duhet të lexojë libra rreth dispozitave të agjërimin ose të pyesë

---

1 Futja e ujit thellë në hundë quhet istinshak, siç përmendet në këtë hadith.

2 Sahihu Ebu Davud (2366).

ata që dinë. Allahu i Madhëruar thotë: **“Nëse nuk dini, pyetni njerëzit e dijes<sup>1</sup>”**.

- 5) Ashtu sikurse njeriu përgatitet para se të shkojë në një udhëtim për gjërat e nevojshme të udhëtimit ose si ai që nisët në luftë përgatitet me plaçkat dhe armët e nevojshme për luftim, po ashtu edhe besimtari kur të vijë sezoni i një adhurimi duhet të mësojë më herët për atë lloj adhurimi, qoftë për haxh, për zekat apo edhe për agjërim.

---

1 El Enbija: 7.

## 32 Transmetohet nga Ibni Abasi, radij-Allahu anhu, se ka thënë:

“Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ishte njeriu më bujar me mirësi, por më bujar ishte kur ishte në Ramazan, kur e takonte atë Xhibrili!”<sup>2</sup>

### **Fikhu i hadithit:**

- 1) Hadithi na mëson bujarinë e madhe të të Dërguarit të Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, e posaçërisht në Ramazan sepse ishte sezoni i nënshtrimeve dhe hajrateve dhe nimetet e Allahut në këtë muaj shtohen.
- 2) Bujarinë e Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, e shpjegon bukur edhe fjala e një beduini kur shkoi te populli i vet: “O popull, pranoni Islamin, se Muhamedi po jep aq shumë, sikur të mos ketë frikë nga varfëria!”<sup>3</sup>
- 3) Bujaria e tij, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ishte shkak që shumë njerëz ta pranojnë Islamin, pasi pas luftës së Hunejnit u dha dhurata të

---

1 Kur Xhibrili e vizitonte Pejgamberin në Ramazan.

2 Transmetojnë Buhariu (1902) dhe Muslimi (2308).

3 Transmeton Muslimi (2312) nga Enesi, radij-Allahu anhu.

shumta disa personave nga plaçka e vet e luftës dhe nuk i mori për vete, vetëm që t'ua përfitonte zemrat dhe që Islami të mbillej fort në zemrat e tyre<sup>1</sup>.

- 4) Bujaria ka disa dobi, si për shembull është shenjë e besimit të plotë dhe e Islamit të mirë, argument i bindjes së fuqishme në premtimet e Allahut, të bën të dashur tek Allahu dhe të afërt me njerëzit, ta shton furnizimin, mallin dhe jetën si dhe ta pastron shpirtin nga koprracia e egoizmi.
- 5) Besimtari forcohet kur e ka shokun e mirë të devotshëm, sikurse bujaria e Pejgamberit, alejhi salatu ves selam, shtohej kur takonte Xhibrilin, alejhi selam.

---

1 Sherhu Rijadis Salihin, faqe 254, El Uthejmin, rahimehullah.

## 33 Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ves sellem, ka thënë:

*“Mosagjërimi në udhëtim është lehtësim nga Allahu, kush punon me të është në rregull<sup>1</sup>, e kush dëshiron të agjërojë, nuk ka mëkat për të<sup>2</sup>”.*

### **Fikhu i hadithit:**

- 1) Meqë udhëtimi është copëz dënimi, siç transmetohet, atëherë sheriati ia ka lehtësuar besimtarit të mos agjërojë ditëve të Ramazanit kur gjendet në udhëtim, meqë Allahu i Lartësuar thotë: **“Allahu me këtë dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështirësim për ju<sup>3</sup>”.**
- 2) Kjo është lehtësim nga Allahu, ndaj kush e zbaton nuk ka kurrfarë mëkati, përkundrazi ka bërë mirë, meqë *“Allahu dëshiron të çohen në vend lehtësimet, ashtu siç dëshiron të zbatohen obligimet<sup>4</sup>”.*
- 3) Hadithi paralajmëron nga shtrëngimi i tepruar në fe kur njeriu është i dobët në kryerjen e

---

1 Është mirë, është më mirë.

2 Transmeton Muslimi (1121).

3 El Bekare: 185.

4 Sahihu et Tergib (1060), Albani.



obligimeve. Allahu thotë: “**Allahu nuk ngarkon askënd përtej mundësive të veta**<sup>1</sup>”.

- 4) Nëse agjërimi në udhëtim ia dëmton dikujt shëndetin, atëherë agjërimi në atë rast nuk preferohet. Pejgamberi, alejhi salatu ves selam, ka thënë: “*Nuk është nga bamirësia agjërimi në udhëtim*<sup>2</sup>”.
- 5) Hadithi është argument se lejohet agjërimi në udhëtim në Ramazan për atë që nuk e ka problem, bile ndoshta është më e mirë për të, se Allahu thotë: “**Por, agjërimi juaj është më i dobishëm**<sup>3</sup>”.
- 6) Imam San’ani, rahimehullah, ka thënë se agjërimi apo mosagjërimi në udhëtim janë të barabartë, për shkak të haditheve të barabarta në këtë çështje, dhe kjo është ajo që duket qartë në hadithin e Enesit, i cili ka thënë: “Udhëtuam me të Dërguarin e Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, dhe as agjëruesi nuk e qortonte mosagjëruesin, e as mosagjëruesi agjëruesin<sup>4</sup>”.

---

1 El Bekare: 286.

2 Transmetojnë Buhariu (1946) dhe Muslimi (1115)

3 El Bekare: 184.

4 Subulus selam (2/450).

## 34 Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sellem, ka thënë:

*“Ndodh që agjëruesi të mos fitojë nga agjërimi i tij përveç urisë dhe ndoshta ai që falet natën të mos fitojë nga ngritja e tij veçse pagjumësinë”<sup>1</sup>.*

### **Fikhu i hadithit:**

- 1) Agjëruesi duhet të ketë kujdes nga nijeti i tij gjatë Ramazanit sepse nëse nijeti i tij nuk është për Allahun e Madhëruar, atëherë e ka lodhur veten me uri dhe nuk ka fituar shpërblime fare.
- 2) Agjërimi ynë në Ramazan nuk duhet të jetë një adet i trashëguar dhe menjëherë pas tij t'u kthehemi mëkateve të vjetra, sepse kështu vetëm kemi mbetur pa ngrënë dhe nuk e kemi arritur synimin e agjërimit, që është devotshmëria dhe kënaqësia e Allahut.
- 3) Ndoshta dikush ka mbetur i uritur sepse e ka humbur shpërblimin e agjërimit duke ngrënë mishin e njerëzve me përgojim ose nuk i ka ruajtur gjymtyrët nga mëkatet<sup>2</sup>.

1 Sahihul Xhamiu (3488).

2 Fajdul Kadir (4/21).

- 4) E njëjta gjë vlen edhe për ata që i falin teravitë vetëm sa për sy e faqe ose falin vetëm teravitë, por nuk janë në gjendje të falin pesë namazet obligative. Kush është ai i mençur që mundohet të japë lëmoshë kur është i zhytur në borxhe të vjetra?
- 5) Edhe agjërimi edhe teravitë ose namazi i natës duhen bërë në pajtim me sunetin e Pejgamberit, alejhi salatu ves selam, sepse edhe agjërimin edhe namazin e kemi mësuar prej tij, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.

# 35 Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

*“Kush harron duke qenë agjërueshëm dhe ha ose pi, le ta plotësojë agjërimin e tij sepse vërtet që Allahu e ka ushqyer dhe i dha të pijë<sup>1</sup>”.*

## **Fikhu i hadithit:**

- 1) Kush ha ose pi nga harresa, agjërimi i tij nuk është prishur.
- 2) Është obligim të vazhdohet ajo ditë nga agjëruesi që ka ngrënë ose pirë nga harresa.
- 3) Vepra e harrestarit nuk i atribuohet vepruesit me shariat, sepse ka ndodhur jo me qëllim.
- 4) Në realitet, në raste harrese Allahu është Ai që e ka ushqyer atë agjërues.
- 5) Meqë ai duhet ta vazhdojë agjërimin e tij, nuk ka nevojë për kurrfarë kompensimi të pastajshëm<sup>2</sup>. Në një transmetim thuhet: *“Kush ha në Ramazan nga harresa, as nuk ka kompensim për të e as shpagim<sup>3</sup>”.*
- 6) Nuk ka rëndësi sa ka ngrënë apo pirë përderisa e ka bërë nga harresa.

1 Transmeton Muslimi (1155).

2 Tevdihul ahkam (3/500).

3 Transmetojnë Buhariu (1933) dhe Muslimi (1155).

- 7) Hadithi na tregon mëshirën e madhe të Allahut me robërit e Tij dhe lehtësimin që u ka bërë dhe vështirësitë që u ka hequr<sup>1</sup>.

---

1 Sherhul umdeh, Fajsal Alu Mubarek, rahimehullah.

## 36 Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

*“Kujt i vjen të vjellë derisa është agjërueshëm, për të nuk ka kompensim<sup>1</sup>, kurse kush vjellë me qëllim, ai e kompenson<sup>2</sup>”.*

### **Fikhu i hadithit:**

- 1) Nëse vjellë me qëllim, e ke prishur agjërimin e asaj dite dhe duhet ta kompensosh.
- 2) Nëse të ka ardhur vetvetiu të vjellët, as nuk e ke pasur me qëllim e as nuk e ke ngacmuar atë qëllimisht, atëherë nuk e ke prishur agjërimin e asaj dite, por vazhdon të agjërosh dhe për ty nuk ka kurrfarë kompensimi.
- 3) Hadithi po ashtu është argument se nëse dikush të detyron të hash me forcë, nuk e ke prishur agjërimin sepse kjo nuk ka ndodhur me qëllim të agjëruesit e as me dëshirën e tij dhe në hadith thuhet:

---

1 Pra, nuk e ka prishur, por e vazhdon agjërimin sepse nuk ka vjellë qëllimisht.

2 Sahihu Ebi Davud (2380).

*“Umetit tim i është falur gabimi, harresa dhe ajo që janë detyruar ta bëjnë”<sup>1</sup>.<sup>2</sup>*

---

1 Transmeton Ibën Maxheh (2045), e saktësoi Albani.

2 Abdullah el Bessam, rahimehullah (Tevdihul ahkam, 5/501).

## 37 Njëri nga shokët e të Dërguarit të Allahut tha:

*“E kam parë të Dërguarin e Allahut, sal-Allahun alejhi ve sel-lem, në (vendin) el Arxhu<sup>1</sup> duke derdhur ujë mbi kokën e tij gjersa ishte agjërueshëm nga etja ose nga vapa<sup>2</sup>”.*

### **Fikhu i hadithit:**

- 1) Hadithi është argument se i lejohet agjëruesit ta thyejë vapën e madhe duke derdhur ujë mbi një pjesë të trupit të tij ose mbi krejt trupin dhe ky është mendimi i pjesës dërrmuese të dijetarëve<sup>3</sup>.
- 2) Nga kjo themi se lejohet larja gjatë ditës për agjëruesin, qoftë pastrim i lejuar (mubah) apo sunet sikur ai i xhumasë apo i obliguar nga xhunubllëku, nëse ka gdhirë ashtu nga marrëdhëniet gjatë natës ose nga xhunubllëku i ëndrrave.
- 3) Kush lahet gjatë ditës duhet të ketë kujdes nga futja e ujit në gojë dhe hundë, siç u sqarua më

---

1 Fshat rrugës për në Mekë.

2 Sahihu Ebi Davud (2365).

3 Avnul meabud (4/443).



lart në hadithin e të Dërguarit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem<sup>1</sup>.

---

1 Transmeton Ebu Davudi (2366).

**38** Nga Aishja, radijAllahu anhu, transmetohet se ka thënë:

*“Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, e puthete (gruan) dhe luante<sup>1</sup> gjersa ishte agjërueshëm, megjithatë ishte më i përmbajturi për epshin i tij<sup>2</sup>”.*<sup>3</sup>

### **Fikhu i hadithit:**

- 1) Hadithi aludon se i lejohet burrit ta puthë gruan e vet gjersa është agjërueshëm në Ramazan nëse është i sigurt që ky veprim nuk e shpie deri në prishjen e agjërimit.
- 2) Lejohet gjithashtu që burri të luajë me gruan e tij duke e prekur trupin e saj, me kusht që kjo mos të shpjerë deri në shpërthimin e epshit për ndonjërin prej tyre.
- 3) Urrehet puthja për atë që epshi i shpërthen lehtë, por nuk urrehet për atë që nuk i ndikohet epshi nga puthja ose prekja.

---

1 E prekte trupin e gruas së vet.

2 E përmbante veten nga prishja e agjërimit.

3 Transmetojnë Buhariu (1927) dhe Muslimi (1106).

Kjo ndarje është përmendur në hadithin ku Pejgamberi, alejhi salatu ves selam, ia lejoi plakut puthjen, por ia ndaloi të riut<sup>1</sup>.

- 4) Pejgamberi, alejhi salatu ves selam, e puthte dhe e prekte gruan e vet, por ishte nga më të përmbajturit nga ejakulimi apo shpërthimi i epshit, sipas dëshmisë së Aishes, radijAllahu anha.
- 5) Lejohet të flitet për gjërat që mund të ketë turp, me qëllimin për të treguar një çështje të fesë, apo që t'i sqarohet diçka mjekut për mjekim, ose në çështjet e gjykimeve, mosmarrëveshjeve e arsimimit<sup>2</sup>.
- 6) Kush ejakulon pas puthjes apo prekjes, e ka prishur agjërimin dhe për këtë është përmendur konsensus nga dijetarët, si Ibën Mundhiri dhe Ibën Kudame.

---

1 Transmeton Ebu Davudi (2387), hadith hasen sahih.

2 Tevdihul Ahkam (3/487).

## 39 Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

*“Kush i jep të hajë një agjëruesi (për iftar), atij i takon shpërblimi sikur i agjëruesit, pa iu pakësuar agjëruesit asgjë nga shpërblimi i vet<sup>1</sup>”.*

### **Fikhu i hadithit:**

- 1) Hadithi nxit për ofrimin e iftarit për agjëruesin, qoftë edhe me disa hurma apo diçka tjetër nga ushqimet e lehta.
- 2) Kush i ofron dikujt iftar, fiton shpërblime sa vetë agjëruesi të cilit i ka ofruar iftarin, por pa iu pakësuar shpërblimi agjëruesit fare.
- 3) Mëshira e Allahut në këtë muaj të begatshëm ndaj robërve të Tij është e madhe, pasi i bëri njerëzit furnizim për njëri-tjetrin.
- 4) Kjo porosi profetike vërteton parimin e madh të Islamit, bashkimin e njerëzve për hir të fesë së Allahut të Madhëruar, siç thuhet në Kuran:

---

1 Transmetojnë Tirmidhiu (807) dhe Ibën Maxheh (1746), e saktësoi Albani.

**“Dhe kapuni që të gjithë ju për litarin e Allahut (librin e Tij dhe udhëzimin e Pejgamberit të Tij<sup>1</sup>), e mos u përçani!”<sup>2</sup>**

- 5) Shoqëritë islame janë më të shëndoshat dhe më të bashkuarat dhe këtë nuk e gjen tek shoqëritë e tjera joislame, sado që reklamohen e nxjerrin ligje të ndryshme.
- 6) Hadithi e nxit të pasurin të mendojë më shumë për të varfrin dhe skamnorin, që kështu të jetë falënderues ndaj Allahut për mirësitë e Tij me gjuhë e me vepër.
- 7) Ofrimi apo shtrimi i iftareve e forcon edhe më shumë lidhjen vëllazërore në Islam dhe e shton dashurinë mes muslimanëve, të cilët bëhen më të fortë dhe më të bashkuar kundrejt çdo sfide të jetës.

---

1 Et Tefsir el Mujesser, komenti i ajetit 103 nga Alu Imran.

2 Alu Imran: 103.

**40** Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem,  
ka thënë:

*“Agjëruesi ka dy gëzime: kur bën iftar dhe kur takon Zotin e vet<sup>1</sup>”.*

### **Fikhu i hadithit:**

- 1) Agjëruesi gëzohet me agjërimin e vet, por kjo nuk ia pakëson shpërblimin në ahiret.
- 2) Lejohet të gëzohemi kur vjen koha e iftarit sepse në realitet ne gëzohemi që përfunduam një nënshtrim me sakrificë për Allahun e Madhëruar dhe kjo nuk e prish sinqeritetin tonë të agjërimin.
- 2) Gëzimi më madhështor dhe më i përsosur është takimi me Allahun, kur durimtarët dhe agjëruesit e marrin shpërblimin e tyre pa llogari.
- 3) Agjëruesi kur e takon Allahun e Madhëruar në ahiret gëzohet që ka me vete agjërimin e dynjasë duke shpresuar shpërblimin, shpëtimin nga zjarri dhe fitoren me xhenet.

---

1 Transmeton Muslimi (1151), në një transmetim te Buhariu (1904): “dhe kur e takon Zotin e tij, gëzohet për agjërimin e vet”.

**41** Transmetohet nga Enesi, radijAllahu anhu, se:

*“Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, kur bënte iftar e fillonte me hurma<sup>1</sup>”.*

**Fikhu i hadithit:**

- 1) Kujdesi i madh i sahabëve në pasimin e sunetit të Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, dhe transmetimin e tij tek umeti.
- 2) Rëndësia dhe pesha e madhe e të mësuarit të tjerëve sunetin e tij, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.
- 3) Udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Muhamedit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.
- 4) Pasimi i tij, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, është shenjë se ti me të vërtetë e do Allahun e Madhëruar dhe mundësi për të të dashur Allahu, qoftë i lavdëruar. Ai ka thënë: **“Thuaj: Nëse e doni Allahun, atëherë ejani pas meje që Allahu t’ju dojë<sup>2</sup>”.**

---

1 Es Sahiha (2117), Albani.

2 Alu Imran: 31.

## 42 Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

*“Njerëzit do të vazhdojnë të jenë në mirësi, përderisa e shpejtojnë iftarin<sup>1</sup>”.*

### **Fikhu i hadithit:**

- 1) Nxitje për ta shpejtuar iftarin kur hyn koha dhe për të mos e vonuar nga koha e vet. Kjo është koha kur disku i diellit humb nga horizonti, edhe nëse në horizont është ende dritë, siç do ta kuptosh në hadithin e radhës.
- 2) Umeti do të vazhdojë të jetë në hair përderisa e praktikojnë atë. Me hair kemi për qëllim hairin e dunjasë dhe mirësitë e ahiretit.
- 3) Në shpejtimin e iftarit dhe në mosvonimin e tij nga koha e vet ka mëshirë për agjëruesin.
- 4) Preferohet bërja iftar para faljes së namazit të akshamit.

---

1 Transmetojnë Buhariu (1957) dhe Muslimi (1098, 48). Vërejtje: Në disa dorëshkrime të librit “Umdetul ahkam” është shtuar shprehja “dhe e vonojnë syfyryn”, mirëpo kjo pjesë nuk gjendet te Buhariu dhe Muslimi, por gjendet te musnedi i Ahmedit (5/147 dhe 172) nga hadithi i Ebu Hurejrës, mirëpo senedi i tij është i pasaktë.



- 5) Nxitje për pasim të sunetit dhe moskundërshtim të tij, përndryshe “*në kundërshtim të tij ka nënçmim dhe poshtërim*” siç thotë Pejgamberi, alejhis salatu ves selam<sup>1</sup>.
- 6) Në hadith ka kundërshtim të shiitëve, të cilët e vonojnë iftarin derisa të shfaqen yjet dhe me këtë vonim ata ranë në përputhje me hebrenjtë, të cilët e vonojnë po aq iftarin<sup>2</sup>, siç transmetohet në hadithin e Ebu Hurejrës, radijAllahu anhu, se Pejgamberi, alejhi salatu ves selam, ka thënë: “*Islami do të qëndrojë triumfues përderisa njerëzit e shpejtojnë iftarin, sepse hebrenjtë dhe të krishterët e vonojnë*”<sup>3</sup>.
- 7) Bërja e iftarit në kohën e vet dhe mosshtryja e bën umetin të qëndrojë në Sunetin e Pejgamberit dhe në rrugën e selefus salih dhe kështu nuk do të devijojë<sup>4</sup>.
- 8) Ibën Haxheri, rahimehullah, ka thënë: “*Mu- ezinët kanë filluar ta thërrasin ezanin një shkallë pas akshamit, me pretekstin që t’ia*

---

1 Sahihul Xhamiu (2831), e saktësoi Albani.

2 Zubdetul e fham, faqe 800.

3 Transmetojnë Ebu Davudi (2353) dhe të tjerët me sened hasen, saktësoi Albani.

4 Behxhetun nadhirin (2/373).

qëllojnë kohës, por kështu e kanë vonuar iftarin dhe e kanë përshpejtuar syfyrin dhe kanë kundërshtuar sunetin, e për pasojë iu pakësua hairi dhe u shtua sherri në ta. Allahu na ndihmoftë nga kjo!”<sup>1</sup>

---

1 Fet’hul bari (4/199).

# 43 Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

“Kur të vijë nata<sup>1</sup> nga këtu dhe të largohet dita nga këtu<sup>2</sup>, e të perëndojë dielli, atëherë agjëruesi vetëm se e ka përfunduar agjërimin (e asaj dite<sup>3</sup>)”<sup>4</sup>

## **Fikhu i hadithit:**

- 1) Në këtë hadith Pejgamberi, alejhi salatu ves selam, ka sqaruar shenjat e kohës së iftarit, të cilat janë tri shenja të pandashme njëra nga tjetra:
  - a) ardhja e mbrëmjes me errësirën e saj nga lindja,
  - b) humbja e ditës me dritën e saj nga perëndimi,
  - c) perëndimi i diskut të diellit nga horizonti.Nëse agjëruesi i konfirmon këto, atij i takon të bëjë iftar sa më shpejt dhe mos ta vonojë<sup>5</sup>.
- 2) Sqarim i kohës kur hyn mbrëmja dhe kur mbaron dita.
- 3) Nxitje për të shpejtuar iftarin, i cili ishte zakoni i sahabëve (Allahu qoftë i kënaqur me ta), siç

---

1 Fillon të shfaqet errësira nga lindja.

2 Fillon të humbë drita e saj nga perëndimi.

3 Atëherë i lejohet të bëjë iftar.

4 Transmetojnë Buhariu (1954) dhe Muslimi (1101).

5 Zubdetul efram, faqe 806.

e transmeton Abdurrezzaku në musanefin<sup>1</sup> e tij me sened të saktë nga Amër ibën Mejmun el Evdij, i cili ka thënë: “Shokët e Muhamedit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ishin njerëzit më të shpejtë në iftar dhe më të vonshmit në syfyr”.

- 4) Nuk duhet harruar se logjika nuk gjykon mbi sheriatin, por sheriati gjykon mbi të, pasi fillimi i hyrjes së natës e ka bërë iftarin të ligjshëm.
- 5) Dikush mund të mendojë se nata nuk fillon me perëndimin e diellit, pra me humbjen e vërtetë të diskut të diellit nga horizonti, meqë mund të ketë dritë akoma, por vetëm pasi të shtrihet errësira në lindje e në perëndim, siç kishte menduar një shok i Pejgamberit, alejhis salatu ves selam. Pejgamberi, alejhis salatu ves selam, ia bëri atij të qartë se paraqitja e parë e errësirës nga lindja me humbjen e diskut të diellit direkt mjafton për të bërë iftar. Këtë hadith tani po e sjellim të plotë: “Abdullah ibën ebi Evfa, radijAllahu anhu, ka thënë: -Ishim me të Dërguarin e Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, në një udhëtim dhe ai ishte

---

1 (7343), Ibën Haxheri në Fet’hul bari (4/199) tha se senedi i tij është i saktë.

agjërueshëm (në transmetimin e Muslimit: *ishte në muajin Ramazan*) dhe kur perëndoi dielli, ai i tha dikujt: -O filan (tek Ebu Davudi: -O Bilal, ngrihu dhe na sill ujë!). Ai tha: -O i Dërguar i Allahut, sikur të ngrysej (te Buhariu: sikur të prisje derisa të ngrysej)! Pejgamberi tha: -Zbrit dhe na sill ujë! Ai tha: -Akoma e ke ditë! Pejgamberi tha: -Zbrit dhe na sill ujë! Atëherë ai zbriti dhe u dha ujë atyre dhe Pejgamberi, alejhi salatu ve selam, piu. Pastaj bëri me gisht kah lindja dhe tha: “Nëse e sheh natën se erdhi nga atje (lindja), agjëruesi veçse ka bërë iftar (përfundoi agjërimin e asaj dite)<sup>1</sup>”.

---

1 Transmetojnë Buhariu (1955) dhe Muslimi (1101).

## 44 Nga Abdullah ibën Umeri transmetohet se ka thënë:

“Ai, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, kur bënte iftar thoshte: *“Iku etja, u lagën venat dhe u fitua shpërblimi inshaAllah (nëse ka dashur Allahu)”*”.

### **Fikhu i hadithit:**

- 1) Udhëzimi i Muhamedit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, është udhëzimi më i mirë, siç thoshte vetë ai, ndaj lutja më e mirë edhe në iftar është lutja e saktë profetike.
- 2) Janë transmetuar lutje të ndryshme për iftar për agjëruesin, por që janë të pasakta, kurse agjëruesit ndjekës të sunetit i mjafton kjo lutje profetike e saktë.
- 3) Kujdesi i Pejgamberit, alejhis salatu ves selam, për t’ia mësuar umetit edhe lutjet me rastin e iftarit.
- 4) Kjo lutje menjëherë pas iftarit është edhe falënderim i agjëruesit ndaj Zotit të vet, që i mundësoi ta përfundonte agjërimin e tij dhe ta shijonte gëzimin e tij.

---

1 Sahihul Xhamiu (4678).

- 5) Kur agjëruesi thotë “*u fitua shpërblimi insha-Allah*”, ai realizon besimin e drejtë të muslimanit, i cili jeton mes shpresës dhe frikës sepse nuk e ka të sigurt nëse ia ka pranuar Allahu agjërimin apo jo, por ai shpreson dhe kjo shpresë e shtyn edhe më shumë për vepra të mira, siç është e sqaruar mirë në detaje në librat e besimit të ehlu sunetit dhe xhematit.
- 6) Agjërimi i agjëruesit është i lidhur fort me të luturit e Allahut të Madhëruar me lutje dhe këtë e vërteton edhe ajeti 186 i El Bekares: **“E kur robërit e Mi të pyesin ty për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjes kur lutësi më lutet”**, i cili vjen menjëherë pas ajeteve të agjërimit 183, 184, 185.

## 45 Transmetohet nga Enes ibën Maliku, radijAllahu anhu, se ka thënë:

“I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, bënte iftar me disa *rutabë* para se të falej (akshami), e nëse nuk kishte *rutabë*, atëherë me *hurma*, e nëse as këtë nuk e kishte, atëherë pinte disa gllënjka ujë<sup>1</sup>”.

### **Fikhu i hadithit:**

- 1) Modestia e madhe e të Dërguarit të Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, e cila është e dukshme edhe në këtë rast. Ky duhet të jetë model i yni në iftaret tona, pa e tepruar siç e kemi zakon. Allahu i Madhëruar për të ka thënë: **“Tek i Dërguari i Allahut ju keni një shembull të mrekullueshëm për atë që shpreson tek Allahu dhe dita e fundit dhe e përmend shumë Allahun<sup>2</sup>”**.
- 2) Hurma *rutabë* është më e njomë se hurmat normale, më e madhe, më cilësore dhe më e shijshme, që do të thotë se i lejohet agjëruesit të hajë së pari nga ajo më e mira dhe kjo nuk e prish thjeshtësinë e kërkuar nga muslimani.

1 Sahihu Ebi Davud (2356).

2 El Ahzab: 21.



- 3) Pejgamberi, alejhis salatu ves selam, ishte modeli ynë edhe në të kënaqurit me pak në çështjet e dunjasë dhe furnizimit të saj, meqë kjo ishte edhe porosia e tij: *“Ka shpëtuar kush u bë musliman, u furnizua mjaftueshëm dhe Allahu e bëri të kënaqej me atë që i ka dhënë<sup>1</sup>”*.

---

1 Transmeton Muslimi (1054).

## 46 Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

*“Kush ngrihet për t’u falur në Ramazan me besim dhe shpresë në shpërblim, atij i falen mëkatet e mëhershme (të kaluara)”<sup>1</sup>.*

### **Fikhu i hadithit:**

- 1) Vlëra e madhe e namazit të natës në Ramazan, që është sunet i fortë, dhe se ai duhet falur me xhemat në xhami.
- 2) Në Ramazan e falim namazin e teravive me xhemat apo namazin e natës në shtëpi me besim të prerë në premtimin e Allahut se do të na shpërblejë dhe duke kërkuar sevap e jo për ndonjë qëllim tjetër të dunjasë apo për syfaqësi.
- 3) Disa dijetarë kanë thënë se falja e mëkateve mund të përfshijë edhe mëkatet e mëdha, nëse nuk ka mëkate të vogla. Ibën Mundhiri, rahimehullah, ka thënë se falja e teravive apo e namazit të natës përfshin edhe mëkatet e vogla edhe të mëdhatë<sup>2</sup>.

---

1 Transmetojnë Buhariu (2009) dhe Muslimi (759).

2 Fet’hul bari (6/8), Ibni Haxheri.

- 4) Imjери ai agjërues të cilit i ikin netët e Ramazanit pa u falur për Allahun e Madhëruar, sepse në realitet i ka ikur falja e mëkateve të mëhershme nga Allahu, të gjitha.
- 5) Sa fatkeqësi e madhe është kur dikush agjëron tërë muajin Ramazan dhe agjëron Ramazane të panumërta, pa ndërprerë, por akoma nuk ka filluar të falë pesë kohët e namazit! Nëse këta njerëz nuk pendohen në këtë muaj, kur shejtanët janë të lidhur, kur do të pendohen për mosfaljen e namazit?!
- 6) Nuk paramendohet agjërimi i Ramazanit pa namazin e teravive ose të natës, varësisht nga përkufizimi i dijetarëve për namazin e natës në këtë muaj, që dëshmon për lidhjen e madhe mes agjërimit dhe namazit në këtë muaj të begatë.

## 47 Nga Aishja, radijAllahu anha, transmetohet se:

“I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, një natë u fal në xhami dhe njerëzit u falën bashkë me të, pastaj u falën natën tjetër dhe u shtuan njerëzit. E kur ata u tubuan natën e tretë dhe të katërt, atyre nuk u doli më i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem. Të nesërmen ai u tha: *“E pashë se çfarë vepruat dhe nuk më pengoi të dilja te ju veçse frika se po u bëhet obligim”*. Dhe kjo ishte në Ramazan<sup>1</sup>”.

### **Fikhu i hadithit:**

- 1) Në kohën e Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, namazi i natës apo teravitë me xhemat nuk janë falur çdo natë ashtu si falen te ne sot, por falja e tyre me xhemat çdo natë kishte ndodhur nga koha e Umerit, radijAllahu anhu, pasi Umeri e pa se njerëzit ndaheshin në grupe, ndaj i bashkoi në një xhemat<sup>2</sup>.
- 2) Namazi i teravive është sunet i fortë, nuk është obligim.

1 Transmetojnë Buhariu (1129) dhe Muslimi (761).

2 Kijamu Ramadan fq.21, të Albanit.

- 3) Pejgamberi, alejhis salatu ves selam, e kishte lënë faljen e rregullt çdo natë të teravive me xhemat nga frika se mos u bëhej obligim muslimanëve dhe pastaj do të ishte e vështirë për ta.
- 4) Namazi i natës ishte obligim për të Dërguarin e Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, por jo edhe për umetin dhe kjo ishte një nga veçoritë e tij.
- 5) I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ishte pejgamber i mëshirës, ndaj dëshironte t'ia lehtësonte umetit të vet. Allahu i Madhëruar për të ka thënë: **“E Ne të dërguam ty (Muhamed) vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat”**<sup>1</sup>, por në të njëjtën kohë edhe i dhimbsej umeti i vet kur përjetonte vështirësi. Allahu i Madhëruar ka thënë: **“Atij i vjen rëndë për vuajtjet tuaja. I brengosur për besimtarët, i butë dhe i mëshirshëm”**<sup>2</sup>.

---

1 El Enbija: 107.

2 Et Tevbe: 128.

# 48 Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

*“Kush ngrihet Natën e Kadrit për t’u falur me besim dhe bindje në shpërblim, atij i falen mëkatet e mëhershme<sup>1</sup>”.*

## **Fikhu i hadithit:**

- 1) Hadithi shpalos vlerën e madhe të Natës së Kadrit. Allahu i Madhëruar shpalli një kap-tinë të veçantë me pesë ajete për të treguar vlerën madhështore të saj e në ajetin e tretë tha: **“Nata e Kadrit është më e vlefshme se një mijë muaj!”**
- 2) Edhe namazi në Natën e Kadrit duhet të bëhet me besim në të dhe vlerën e caktimeve që ndodhin në të, duke shpresuar në shpërblimin e saj nga Allahu i Lartësuar.
- 3) Gjithashtu falja e Natës së Kadrit është shkak për faljen e të gjitha mëkateve të mëhershme<sup>2</sup>, ndaj besimtari duhet të jetë vigjilent në shfrytëzimin e saj në maksimum me namaz, lexim të Kuranit, përmendje të Allahut, me

---

1 Transmetojnë Buhariu (1901) dhe Muslimi (760).

2 Fet’hul bari (5/589).

kërkim falje e lutje të shumta përgjëruese nga zemra vigjilente.

- 4) Buhariu, rahimehullah, kur e ka vendosur këtë hadith në sahihun e tij, para tij ka sjellë fjalën e Aishes, radijAllahu anha: “Ringjallen sipas nijeteve të tyre”, për një ushtri që do ta luftojë Qabenë derisa të arrijnë në një tokë dhe ajo i përpin ata”. Ibni Haxheri për këtë thotë se ai (Buhariu) ka dashur të tregojë sa peshë të madhe ka nijeti i njeriut në veprat e tij<sup>1</sup> e në këtë rast edhe nijetin për namaz në Natën e Kadrit.

---

1 Fet’hul bari (5/588).

## 49 Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

*“Kërkojeni Natën e Kadrit në dhjetëshen e fundit të Ramazanit!”<sup>1</sup>*

### **Fikhu i hadithit:**

- 1) Nxitje për përpjekje maksimale në kërkimin e Natës së Kadrit në dhjetëshen e fundit.
- 2) Shtytje për të shfrytëzuar maksimalisht kohët e vlefshme me adhurim e nënshtrime, që të mos pendohemi për humbjen e tyre në ahiret.
- 3) Dëshira e Muhamedit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, që t'i orientonte muslimanët kah më e lehta.
- 4) Rreth përcaktimit të Natës së Kadrit janë transmetuar hadithe të shumta dhe mendimi më i preferuar pas bashkimit të të gjitha argumenteve është se Nata e Kadrit duhet të jetë në netët teke të dhjetëshes së fundit të Ramazanit.

---

1 Transmeton Tirmidhiu (792), saktësoi Albani. Te Buhariu (2017) dhe Muslimi (1169) thuhet: “Kërkojeni Natën e Kadrit në tekun e dhjetëshes së fundit të Ramazanit”, por pjesa “tekun” është nga fjalët e transmetimit të Buhariut vetëm dhe jo edhe të Muslimit siç e vërteton Zerkeshiu, rahimehullah, në “En Nuket”, faqe 189.



- 5) Kjo nuk do të thotë që muslimani të tregohet neglizhent në netët çift të dhjetëshes së fundit, përkundrazi, kush ia ka mësyre xhenetit seriozisht, nuk bën dallim mes netëve teke dhe çift në aspektin e namazit dhe nënshtrimeve të tjera.

**50** Nga Aishja, radijAllahu anha, transmetohet se ka thënë:

*“Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, bënte itikaf në dhjetëshin e fundit të Ramazanit<sup>1</sup>”.*

**Fikhu i hadithit:**

- 1) Aishja, radijAllahu anha, na lajmëron se Pejgamberi, alejhis salatu ves selam, nuk iu nda itikafit çdo vit në dhjetëshin e fundit të Ramazanit dhe këtë e bëri derisa vdiq.
- 2) Preferohet praktikimi i itikafit në dhjetëshin e fundit të Ramazanit çdo vit.
- 3) Itikafi si koncept është vetmi e robit me Krijuesin e vet dhe shkëputje e përkohshme nga krijesat e tjera për t’iu përkushtuar vetëm Krijuesit.
- 4) Itikafi vlen për të dyja gjinitë, nëse plotësohen kushtet, meqë edhe gratë e Pejgamberit, alejhis salatu ves selam, e praktikonin itikafin në Ramazan.
- 5) Itikafi duhet bërë vetëm në xhami e jo në vende të tjera.

---

1 Transmeton Buhariu (2033).

**51** Nga Aishja, radijAllahu anha, transmetohet se ka thënë:

*“I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ishte shumë i zellshëm (në adhurim) në dhjetëshen e fundit aq sa nuk ishte i tillë në ditët e tjera<sup>1</sup>”.*

**Fikhu i hadithit:**

- 1) Duke e ditur vlerën e madhe të asaj nate, siç e ka përshkruar Allahun në kaptinën El Kadër, se është më e mirë se një mijë muaj, se në të zbresin melaiket dhe Xhibrili, se caktohen furnizimet e tërë vitit dhe se është paqe deri në mëngjes, atëherë pa dyshim se i Dërguari i Allahut ishte shumë i zellshëm në këtë ditë e natë.
- 2) Meqë ai, alejhis salatu ves selam, ishte aq i zellshëm në atë pjesë të muajit, edhe muslimani duhet ta ndjekë në këtë rrugë pejgamberin e vet, i cili është shëmbëlltyra e tij e përsosur.
- 3) Të mirat e Allahut nuk arrihen pa përpjekje dhe sakrifica të mëdha, sepse malli i Allahut është i shtrenjtë.

---

1 Transmeton Muslimi (1175).

- 4) Kohët e vitit dallojnë tek Allahu për nga vlefshmëria, ndaj njeriu duhet të jetë vigjilent dhe t'i shfrytëzojë ato për të mirën e fesë dhe të shpëtimit të tij në ahiret.
- 5) Nëse i Dërguari i Allahut, alejhis salatu ves selam, i cili i kishte gabimet e falura, ishte aq i zellshëm në adhurimin e tij, çfarë të themi për veten tonë, si krijesa gabimtare natë e ditë?! Pa dyshim se ambicia jonë duhet të jetë në kulmin e vigjilencës, që mos ta humbim kohën në dhjetëshin e fundit të Ramazanit, aq më shumë kur nuk e dimë a do të arrijmë Ramazanin tjetër apo jo.

**52** Nga Aishja, radijAllahu anha, transmetohet se ka thënë:

*“Kur hynte dhjetëshi (i fundit) Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, i shmangej marrëdhënieve intime (me gratë e tij) dhe tërë natën e tij e kalonte (në adhurim) dhe ftonte edhe familjen e tij<sup>1</sup>”.*

### **Fikhu i hadithit:**

- 1) Me fillimin e dhjetëditëshit të fundit, preferohet shtimi i adhurimit dhe kalimi i netëve me adhurime të ndryshme.
- 2) Dhjetët netët e fundit të Ramazanit janë netët më të mira të tërë vitit, për shkak të veçorive të tyre, ndaj edhe i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, i kalonte këto net në adhurim duke e shtuar adhurimin deri në syfy<sup>2</sup>.
- 3) Fjala e Aishes, radijAllahu anha: *“Kur hynte dhjetëshi i fundit”* tregon se Pejgamberi, alejhis salatu ves selam, ishte i përgatitur për këto net<sup>3</sup>, sepse në momentin që fillonin, edhe ai fillonte

---

1 Transmetojnë Buhariu (2024) dhe Muslimi (1174).

2 El Minhaxhu (8/71), Neveviu.

3 Tevdihul ahkam (3/570).

adhurimin e madh, saqë në transmetime të ndryshme përmendet se edhe këmbët e tij ënjtëshin nga namazi i gjatë i natës. E, kur i thuhej se shumë po falej, ai thoshte: “*A nuk duhet të jem rob falënderues?*”<sup>1</sup>

- 4) Distanca e tij nga gratë gjatë kësaj kohe tregon se muslimani këtë kohë duhet të jetë sa më larg kënaqësive të dunjasë, që zemra dhe gjymtyrët e tij t'i përkushtohen adhurimit të Allahut.
- 5) Kujdestari i familjes duhet të mendojë edhe për adhurimin e anëtarëve të familjes së vet e jo vetëm për vete, ashtu siç ka vepruar shëmbëlltyra jonë, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, i cili e ka ftuar edhe familjen e vet që të falin namaz nate bashkë me të dhe të bëjnë edhe adhurime të tjera, si lexim Kurani, përmendje të Allahut dhe lutje të ndryshme.
- 6) Nxitja për adhurimin e vazhdueshëm e përmendur në dhjetëshin e fundit është nxitje për ta përfunduar muajin sa më mirë, Allahu na dhëntë përfundim të mirë!<sup>2</sup>

---

1 Transmetojnë Buhariu (4836) dhe Muslimi (2819).

2 Fet'hul bari (6/36).

**53** Nga Aishja, radijAllahu anha, transmetohet se ka thënë:

“Thashë: -O i Dërguar i Allahut, nëse ia qëlloj Natës së Kadrit, me çfarë (lutje) të lutem? Ai, sal-Allahu alejhi ve sel-lem, tha: *“Do të thuash: -O Allahu im, vërtet Ti je Falës, e do faljen, ndaj më fal mua!”*<sup>1</sup>

### **Fikhu i hadithit:**

- 1) Duke pasur parasysh vlerën e madhe të dhjetëshit të fundit, kujdesi i Aishes për lutjen më të mirë na mëson vlerën e lutjes në këto ditë e net për agjëruesin dhe falësin e namazit të natës.
- 2) Si në shumë hadithe të tjera, edhe në këtë hadith mësojmë se brenga kryesore e sahabëve ka qenë se si t’i afrohen Allahut më së miri, si t’i luten më së miri Atij, që në këtë mënyrë të fitojnë faljen e Allahut dhe kënaqësinë e Tij.
- 3) Kjo duhet të jetë edhe brenga e çdo muslimani, çështja e fesë dhe e ahiretit të tij, siç na e ka mësuar Pejgamberi, alejhis salatu ves selam,

---

1 Transmetojnë Tirmidhiu (3513), Ibën Maxheh (3850) dhe të tjerët, e saktësoi Albani.

lutjen: “O Allah, ma përmirëso mua të kapurit tim për fe, e cila është mbrojta e çështjes sime! Ma ndreq dunjanë time, që të jetoj (riskun hallall) dhe ndreqma ahiretin tim, ku do jem përgjithmonë!”<sup>1</sup>

- 4) Nga cilësitë e Allahut është falja. Ai është Falësi, e do faljen e robërve, ndaj besimtari duhet të kërkojë prej Tij atë që është më e dashur tek Ai dhe njëherazi më e dobishme për muslimanin në ahiret.
- 5) Dijetarët thonë se nëse njeriu e arrin faljen e Allahut në ahiret, atëherë ky është shpëtimi i tij nga zjarri i xhehenemit dhe pastaj për të vijojnë pandërprerë të mirat e Allahut në xhenet.

---

1 Transmeton Muslimi (2720).



**54** Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

*“Umreja në Ramazan llogaritet si të kryesh një haxh ose një haxh me mua<sup>1</sup>”.*

**Fikhu i hadithit:**

- 1) Nga adhurimet e pëlqyera dhe me shumë sevape në Ramazan është edhe umreja, vizita e Qabesë, e cila përfshin tavafin, dy rekatet te Mekami Ibrahim, Sa'ajin dhe Merven dhe në fund qethjen e flokëve ose rruajtjen e tyre.
- 2) Kush e bën umren në Ramazan, fiton shpërblime sikur të ketë kryer haxhin, por jo se është e barabartë sikur të ketë kryer haxhin<sup>2</sup>.
- 3) Për ta nxitur edhe më shumë këtë vepër të mirë, Pejgamberi, alejhis salatu ves selam, tha: *“ose haxhin me mua”*, pra mund të shtohet shpërblimi. E kush është ai që nuk do të kishte dëshirë të kryente një haxh me të Dërguarin e Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem? Atëherë bëje umren në Ramazan!

---

1 Transmetojnë Buhariu (1863) dhe Muslimi (1256).

2 El Minhaxhu (9/2), Neveviu, rahimehullah.

## 55 Transmetohet nga Abdullah ibën Umeri, radijAllahu anhu, se ka thënë:

*“I Dërguari i Allahut e bëri të obliguar zekatul-fitrin një sa’a<sup>1</sup> nga hurma ose një sa’a nga elbi për robin dhe për të lirin, për mashkullin dhe për femrën, për të voglin dhe të rriturin nga muslimanët dhe urdhëroi që të jepet para se njerëzit të dalin për namaz (të Bajramit)<sup>2</sup>”.*

### **Fikhu i hadithit:**

- 1) Nga përsosmëria e sheriatit islam dhe të mirat e tij është se e ka bërë të obliguar atë që pastron shpirtrat dhe përmirëson veprat dhe njëherazi forcon lidhjen vëllazërore dhe dashurinë, e ky pastrues, përmirësues e forcues i lidhje vëllazërore është zekatul-fitri.
- 2) Zekatul fitri apo vitrat, siç njihen në popull, janë të detyrueshme, pra obligim për çdo musliman mashkull apo femër, të lirë apo rob, të madh apo të vogël.

---

1 Sa’a është sasi matëse, e barabartë me katër herë dy grushte të mbushur me ushqim.

2 Transmetojnë Buhariu (1503) dhe Muslimi (984).

- 3) Hadithi ka sqaruar edhe sasinë e dhënies së vitrave, që e sqaruar në fusnotë, në baza ushqimore të një vendi apo populli. Janë përmendur hurmat dhe drithërat, por lejohen edhe gjëra të tjera ushqimore që përdor më shumë një popull, si orizi, fasulja apo edhe diçka tjetër.
- 4) Koha e dhënies së vitrave është deri në momentin e daljes për namazin e Bajramit, por nëse ato vonohen pas kohës së këtij namazi, atëherë konsiderohen sadaka e rëndomtë dhe obligimi i vitrave nuk është kryer.
- 5) Shumica e dijetarëve kanë thënë se vitrat duhet të jepen ushqim dhe jo të holla, rroba apo diçka tjetër, përpos hanefive, të cilët e kanë lejuar të jepen edhe të holla<sup>1</sup>.

---

1 El Mugni (4/295), Ibën Kudame, rahimehullah.

**56** Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sellem, ka thënë:

*“Kush e agjëron Ramazanin, pastaj e pason atë me agjërimin e gjashtë ditëve nga shevali, i llogaritet sikur të agjërojë tërë kohën<sup>1</sup>”.*

### **Fikhu i hadithit:**

- 1) Adhurimi i Allahut të Madhëruar nuk ndalet kurrë derisa të vdesim, ashtu siç na ka porositur në Kuran: **“Dhe adhuroje Zotin tënd derisa të të vijë vdekja<sup>2</sup>”**, por kur adhurimet pasojnë njëra-tjetrën me premisa të shtuara, atëherë njeriu i bën ato me plot dëshirë duke shpresuar shpërblimin e madh nga Krijuesi.
- 2) Mëshira e madhe e Allahut, që për vetëm gjashtë ditë agjërimi pas një muaji agjërim të Ramazanit të na llogaritet sikur të kemi agjëruar tërë vitin.
- 3) Ato ditë të shevalit mund të agjërohen ndaras por edhe të gjitha së bashku, rëndësi ka të jenë brenda këtij muaji.

---

1 Transmeton Muslimi (1164).

2 El Hixhr: 99.

- 4) Agjërimi i shevalit është një ilustrim unik i fjalës së Allahut të Madhëruar: “**E kur ta kryesh (obligimin), atëherë mundohu me adhurim (Allahut). Dhe vetëm te Zoti yt përqendroje synimin!**”<sup>1</sup>

---

1 Esh Sherh: 7-8.

**57** Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sellem, ka thënë:

*“Agjërimi i tri ditëve nga çdo muaj dhe Ramazani pas Ramazanit është si të ketë agjëruar krejt kohën<sup>1</sup>”.*

### **Fikhu i hadithit:**

- 1) Hadith i ngjashëm me hadithin e mëparshëm, ku Pejgamberi, alejhis salatu ves selam, nga mëshira e tij ndaj umetit të vet nxit që përmes agjërimit të mos na humbë asnjë kohë pa u shpërblyer me sevape.
- 2) Dijetarët kanë pasur mospajtime rreth këtyre tri ditëve, se cilat janë ato. Shumica e tyre janë të mendimit se janë tri ditët e bardha të çdo muaji që janë përmendur në hadithe të tjera dhe ato ditë janë dita e 13-të, e 14-të dhe e 15-të e çdo muaji. Ky është edhe mendimi i shumicës së sahabëve<sup>2</sup>.
- 3) Këto hadithe të sakta pejgamberike rreth vlerës së agjërimit dhe shpërblimit të madh na tregojnë se sa shumë Allahu i Madhëruar e

---

1 Transmeton Muslimi (1162).

2 El Minhaxh (8/52), Neveviu, rahimehullah.

do këtë adhurim trupor e shpirtëror, prandaj përmes të Dërguarit të Tij na i ka kumtuar këto këshilla hyjnore.

Salavatet e Allahut qofshin mbi Pejgamberin tonë, Muhamedin!

Dhe lutja jonë e fundit është se falënderimi i takon vetëm Allahut, Zotit të botëve!





## HADITHE TË FAMSHME TË PASAKTA RRETH RAMAZANIT

- 1- *“Fillimi i Ramazanit është mëshirë, mesi i tij është falje, kurse fundi i tij është lirim nga zjarri”*. Hadith munker (Es Silsile ed Daife, 1569, Albani)
- 2 – *“Agjëroni, do të jeni me shëndet”*. Hadith daif (i pasaktë, Es Silsile ed Daife, 253, Albani)
- 3 – *“Sikur ta dinin njerëzit se çështë Ramazani, umeti im do të kishte shpresuar që tërë viti të jetë Ramazan”*. Hadith i shpikur (Daifu et Tergib, 596, Albani)
- 4- *“O Allah, na begato në Rexheb dhe Shaban dhe na e mundëso Ramazanin!”* Hadith daif (i pasaktë, Daiful xhamiu, 4395, Albani)
- 5 – *“Pejgamberi, alejhis salatu ves selam, kur bënte iftar, thoshte: “O Allah për Ty agjërova dhe me furnizimin Tënd bëra iftar”*. Hadith daif (i pasaktë, Daiful xhamiu, 4349i Albani)
- 6 – *“Gjumi i agjëruesit është adhurim”*. Hadith daif (i pasaktë, Es Silsile ed Daife, 4996, Albani)

- 7 – *“Kush e prish një ditë në Ramazan pa asnjë lehtësim e as sëmundje, ai nuk mund ta kompensojë atë edhe nëse agjëron tërë kohën”*. Hadith daif (Daifu et Tirmidhi, 723, Albani)
- 8 – *“Mos thoni “Ramazan” sepse Ramazani është emër nga emrat e Allahut të Lartësuar, por thoni: muaji i Ramazanit”*. Hadith i kotë (Es Silsile ed Daife, 6768, Albani)



**Hadithe të zgjedhura rreth muajit Ramazan  
(57 hadithe të sakta me shpjegime dhe dobi)**

*Përshtati dhe shpjegoi*

Zejd Haziri

*Redaktoi*

Arian Koçi

*Dizajni*

Bashkim Mehani

*Botues*

“Urtësia”

*Tirazhi:*

250 copa

Botimi i parë

1444/2023

**Katalogimi në botim – (CIP)**

**Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”**

28

Haziri, Zejd

Hadithe të zgjedhura rreth muajit Ramazan : (57 hadithe të sakta për muajin Ramazan) / Zejd Haziri.  
- Gjilan : Botimet Urtësia, 2023. - 42 f. ; 20 cm.

ISBN 978-9951-9105-5-2